



## Java e Bibliotekës

**B**iblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës në fillim të këtij muaji (3 – 8 prill) po nis edicionin e katërt të *Javës së Bibliotekës në Kosovë*. Ky është viti i katërt që BKUK dhe Zyra Amerikanë në Prishtinë, si themelues të kësaj veprimtarie, po organizojnë në partneritet këtë ngjarje më rëndësi për kulturën dhe bibliotekarinë në Kosovë.

Organizimi i kësaj *Java* përfshin aktivitete të rëndësishme përmbajtjesore në përputhje me interesimet kulturore, por dhe të zhvillimit krejt të veçantë që e preokupojnë komunitetin bibliotekar.

*Java* në programin e përgatitur ka paraparë seminare, ligjërata, ditën e dhurimit të librit, pjesë muzikore, mbrëmje poetike dhe aktivitetet të tjera e vizita institucioneve kulturore e arsimore. *Java e Bibliotekës në Kosovë*, ashtu si edhe viteve të kaluara, edhe sivjet do t'i japë mbështetje të fuqishme kulturore dhe bibliotekarisë në Kosovë.

Ky aktivitet po afron mundësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar me përfaqësues të bibliotekave moderne të Evropës e të SHBA-së, pjesëmarrja e të cilëve i kanë garantuar sukses këtij manifestimi.

Punimet dhe ligjëratat që lexohen gjatë *Javës së Bibliotekës në Kosovë*, me temë nga bibliotekaria, arti, historia, të ekspertëve bibliotekarisë, studiuesve, përfaqësuesve të kulturës e përkrahës të saj, tashmë janë duke u botuar nga BKUK-ja në edicionin *Java e Bibliotekës*. Materialet që lexohen gjatë *Javës*, sidomos ato nga fusha e bibliotekarisë, bëhen referencë për bibliotekarët kosovarë, nga këto përfitohet shpeshherë për të ndërmarrë hapa në punët praktike në bibliotekë dhe për të gjetur fjet e shkathtësisë për iniciativa konkrete.

Në debatet dhe ligjëratat e edicionit të kaluar të *Javës së Bibliotekës*, janë dhënë shpjegime, informacione, përshkrime e ilustrime, në të cilat janë

gjetur përgjigje, rekomandime e udhëzime në shumë nga çështjet esenciale që e preokupojnë bibliotekarinë dhe bibliotekar në Kosovë.

*Java* vijon t'i kënaqë nevojat e kolegëve bibliotekarë në Kosovë, që nuk mund të marrin pjesë në seminare e punime shkencore jashtë, duke përfituar nga ligjëratat dhe dialogu që zhvillohet në fushën e kulturës së bibliotekarisë. Tash kur BKUK ka shpallur këtë vit si Vit të Profesionalizmit të Bibliotekës e, njëkohësisht, edhe të formimit të Qendrës së Bibliotekës Universitare, misioni i së cilës do të jetë ofrimi i shërbimeve cilësore për studentët e Universitetit të Prishtinës, *Java* me temat bosht të saj do të inkurajojë kurorëzimin me sukses të këtyre projekteve.

Profili i tashëm dhe i ardhshëm i *Javës së Bibliotekës në Kosovë* janë fati i librave e i kulturës, artikulimi i asaj që quhet shqetësim për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

# “Bibliothecae 5”

**B**iblioteka Kombëtare e Shqipërisë, përpara komunitetit bibliotekar, paraqitet me numrin e ri të revistës "Bibliothecae 5", 2004, organ i kësaj biblioteke.

Bibliothecae është revistë profesionale e shkencore nga fusha e bibliotekarisë dhe kulturës në përgjithësi. E ndarë në kaptina dhe pjesë të veçanta sipas fushave, kjo revistë përmban materiale me rëndësi të veçantë.

Ky numër fillon me tekstin e Dr. Aurel Plasarit, drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, i shkruar me rastin e 60-vjetorit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, dhe pason me shkrimin e drejtorit të BKUK-së - Dr.

Sali Bashota, po ashtu fjalim i mbajtur gjatë këtij përvjetori.

Një shkrim tjetër me vlerë të veçantë shkencore - i Dr. Aurel Plasarit, është ai që flet për kodikun e shek. XVIII, i panjohur dhe i pastudiuar gjerë me tani, që bën fjalë për Shën Nikodhimin e Beratit. Ky kodik është pronë e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë.

Me shumë interes është kaptina "Veprimtarë të Albanologjisë", në të cilën është përshkruar biografia dhe veprimtaria e 13 njerëzve të mëdhenj, të cilët kanë dhënë kontribut të çmuar në fushën e albanologjisë.

Fusha e bibliotekarisë në këtë numër është e prezantuar me disa shkrime që kanë të bëjnë me botimet elektronike; sistemin informativ të Bibliotekës Kombëtare, katalogimin në botim (CIP-in); kopjen e detyruar etj.

Në këtë revistë janë prezantuar edhe projekte të reja, dokumente dhe deklarata ndërkombëtare për "Shoqërinë e Informacionit" dhe atë të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), pastaj ngjarje, promovime, manifestime e veprimtari ndërkombëtare nga fusha e bibliotekarisë. Në shërbim të komunitetit bibliotekar, janë informacionet që jepen duke prezantuar tituj të rëndësishëm të rekomanduar të librave nga fusha e bibliotekarisë, si dhe të artikujve nga kjo fushë. Në Bibliothecae është edhe fjalorthi i terminologjisë bibliotekare, që vijon të prezantohet me fjalë e shprehje të reja - i përgatitur nga znj. Farfuri Xhaja.

G.J. B.



## Në këtë numër



Ndrrë Mjeda në Kosovë..... 4

Java e Bibliotekës dhe komunitetet.....6

Pasurimi i koleksioneve të  
lëndëve mësimore ..... 7

Të kuptuarit e formatit MARC për njësi  
bibliografike.....8

Zhvillimi i Bibliotekës Universitare.....15

Përkrahja e bibliotekarisë amerikane  
për Kosovën.....16



[www.biblioteka-ks.org](http://www.biblioteka-ks.org)

**Botues:** BKUK • **Kryeredaktor i botimeve:** Dr. Sali Bashota

**Kryeredaktor:** Fazli Gajraku

**Këshilli redaktues:** Dr. Bahtie Gërbeshi-Zylfiu, Mr. Shukrie Rama, Bedri Gashi, Gjon Berisha, Besim Kokollari

**Lektore:** Hazbije Qeriqi • **Realizimi kompjuterik:** Hekuran Rexhepi

**Fotoreporter:** Bashkim Binaku

**Adresa:** Sheshi "Hasan Prishtina", p.n. Prishtinë

**Tel:** ++381 38 225-605, **Fax:** ++381 38 248-940 • **e-mail:** [biblioteka@biblioteka-ks.org](mailto:biblioteka@biblioteka-ks.org)

# Për festën historike të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës\*



por me siguri edhe politik e social, siç mund të përfytyrohet të këtë qenë ai i 1944-ës. Është një akt që i bënë nder historisë së kulturës së Kosovës, por dhe asaj shqiptare në përgjithësi.

Përshtypja ime është se përdoruesit e bibliotekave, sikurse i quajmë në gjuhën teknike "lexuesit", janë të prirur të mendojnë gjithnjë se "dimrat e mendimit" i kemi kaluar, se i kemi tanimë mbrapa. Krijuesit dhe mbarështuesit e bibliotekave, përkundrazi, me punën e tyre vijojnë të jenë ende ata që ndryshojnë duke llogaritur ngaherë dimra të rinj mendimi, dimra të mundshëm, që dikur mund të na presin përpara. Ky më duket të jetë kulmi fisnik i punës së tyre. Për këtë arsye të gjithë ata që punojnë ende sot për të ngritur biblioteka të reja,

prej atyre komunale/bashkiake tek ato shkollore, si dhe për të mbarështuar bibliotekat tanimë historike, e kanë të drejtën të ndihen paksa - të ndihemi paksa - "perandorë të vegjël". Me këtë ndjesi dëshiroj të përshëndes festën historike të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe të uroj që së bashku të marrim pjesë si në festa përvjetorësh, ashtu dhe në ceremoni themelsh të reja, me shpresë në mote në pranverë "meteorologjike" e jo me dimër, si në Kosovë dhe në Shqipëri.

(Nga fjala e Dr. Aurel Plasari në ceremoninë festive të 60-vjetorit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës)

\*Titulli është i redaksisë

**N**ë themelues historik shumë institucionesh emërmëdha, perandori Hadrian, thoshte me gojën e shkrimtares Margueritte Yourcennar se "të ngrehesh një bibliotekë do me thënë të grumbullosh rezerva në hambar për të përballuar dimrat e mendimit, që gjithnjë priten të vijnë". Punëtorët e librit që, këtu e 60 vjet të shkuar, themeluan ish-bibliotekën Krahinore të Kosovës, atëherë në Prizren, sot Biblioteka Kombëtare dhe Universitare në Prishtinë, mund të mos e kenë ditur këtë parim, por instinkti i tyre prej krijuesish të hambareve duket të ketë funksionuar me përsaktësi: ndoshta aspak rastësisht ata e themeluan këtë bibliotekë në një dimër jo vetëm "meteorologjik",



# Ndre Mjeda në Kosovë

(Në 140-vjetorin e lindjes)

MR. TAHIR FONIQI

HYRJE

Poeti Ndre Mjeda (1866-1937) është njëri prej romantikëve tanë më të shquar. Takimi me veprën poetike të këtij poeti (haset edhe me mbiemrat: Mjedja e Miedia) në Kosovë, me sa dihet deri më tash, ndodh më 1948 përmes poezisë "Bylbyli në pranverë", botuar në një tekst shkollor për nevojat e shkollarëve fillestarë të Kosovës. Fjala është për katër strofat e para, 12 vargje, të poemës së parë të Ndre Mjedës "Vaji i bylbylit", shkruar më 1887. Poezia fillon me vargun: "Po shkrihet bora" e përfundon me vargun: "Po e gzon gjith k'nd".

Mjeda në Kosovë është poet i dashur dhe i çmuar, që sot lexohet edhe në mënyrë dixhitale. Fjala është për librin Vjersha të zgjedhura për fëmijë, botim i Qendrës për Edukim dhe Përparim 2005. Me emrin e Ndre Mjedës vepron edhe Shoqata e Enigmatikëve në Gjilan. Në Kosovë është ribotuar edhe Bibliografia e Ndre Mjedës në përkujdesje të Dr. Begzad Baliut e hartuar nga Jup Kastrati, botuar në Shkodër më 1967. Ndërsa ne e kemi hasur edhe një poezi kushtuar Ndre Mjedës nga Hasan Hasani. "Mund të them me kënaqësi se sot për sot Mjeda është autori më i studiuar në letërsinë tonë të traditës", ka thënë Mentor Quku. Ndërsa Sabri Hamiti për Ndre Mjedën shton: "E para, poezinë e tij e kemi pasur jo vetëm lekturë të obligueshme, po edhe të dashur që nga mësimet e para të letërsisë në fillore. Shumë ide të tij, vargje të tij, shumë vjersha të tij jo vetëm se i kujtojmë përmendësh, po i kemi bërë edhe pronë të dijes personale, na kanë hyrë në mënyrën e të menduarit". Në Kosovë Ndre Mjedën e



Ndre Mjeda (1866 - 1937)

njohim kryesisht si poet për fëmijë e të rritur. Por edhe, hartues të teksteve shkollore, autor të artikujve e studimeve lidhur me gjuhën shqipe, krijues të përrallëzave e gjëegjezave (kashelasha), si kjo:

Vjamë kam trupin, pambuk  
shpirtin,

Një flakë t'vogël kam mbi kry  
Gjithkujt dritën duke shkëlqy  
Ja jap, emrin kush ma di! (6) etj.

## MJEDA NË BOTIMET PERIODIKE E MONOGRAFIKE

Në botimet periodike Mjedën e hasim që nga viti 1962. Fillimisht është prezantuar në gazetën e revistat: "Rilindja", "Zani i Rinisë", "Jeta e Re", "Pionieri", "Thumbi" etj. Në këto organe ai është prezantuar sidomos me poezitë: "Vaji i bylbylit", "Lissus", "Skodra", "Uzdaja pa dobi", "Vorri i Skanderbegut", "Edhi e ujku", "Figurja në mur", "Zemër forti e zemër trimi", "Filxhani i kafes" (fragment), "Vjeshta", etj.

Në mënyrë më të denjë Ndre Mjeda është prezantuar në botimet mono-

grafike: në tekstet shkollore, në antologji e botime të tjera të ngjashme. Në këto botime hasen sidomos poezitë: "Bylbyli në pranverë", "Andrra e jetës", "Dimni", "I tretuni", "Lejleku", "Malli për atdhe", "Prendvera", "Scodra", "Trina", "Vera", "Vjeshta", "I mbetuni", "Lokja", "Mbreti i Tules" (W. Goethe), "Shtegtari", "Vaji i bylbylit", "Vaji i dalëndyshes", "Zoga", "Andërr", "Lissus", "Gjuha shqipe", "Mustafa Pasha në Babunë", etj. Më së shumti janë prezantuar vjershat: "Andrra e jetës", "Vjeshta", "I tretuni", "Dimni", "Prendvera", "Vera", "Vaji i bylbylit", etj. Këto poezi janë botuar në tekstet e ndryshme shkollore dhe titujt: Antologji e letërsisë shqipe, mbarështuar nga Hasan Vokshi, Elhami Nimani e Tajar Hatipi, Prishtinë, 1954, Antologji e letërsisë shqipe (prej De Radës e këndeje) e Rexhep Qosjes - Prishtinë, 1970, Nga poezia e traditës, I, II, Prishtinë, 1977 e Kajtaz Rrecajt, Lulëkuqet e majit, Prishtinë, 1978 e Rexhep Hoxhës etj.

Në mënyrë më të plotë Ndre Mjeda është prezantuar më 1962 me librin poetik Vjersha dhe poema në përgatitje të poetit Enver Gjerqeku. Ky vëllim ka 30 vjersha, 1630 vargje dhe është ndarë në pesë cikle: "Juvenilia" (3 vjersha), "Lirika të ndryshme" (4), "Poema" (3), "Vjersha për fëmijë" (17) dhe "Prej gjuhës së hueja" (3). Vëllimi ka hyrjen, titulluar Ndre Mjeda nga Enver Gjerqeku. ÷shtë botuar në 10000 kopje. Ky titull ka pasur vetëm një botim. Ndërkaq më 1966 Mjeda prezantohet me librin tjetër Përmbledhje vjershesh për fëmijë, në zgjedhje e shpjegime nga Anton Çetta. Ky vëllim ka 53 vjersha, përrallëza e kashelasha. Libri ka tekstin hyrës dhe pashënien nga Anton Çetta. ÷shtë botuar në 3000 kopje.

Ndërkaq më 1990, Ndre Mjeda prezantohet me titullin Juvenilia, botim

i Shtëpisë botuese Rilindja, që do ta këtë një ribotim më 2001 nga Shtëpia botuese Libri shkollor. Këta tre tituj janë botuar në 23000 kopje e përfshijnë 406 faqe tekst shtypi ose 25 tabakë (pa ribotime). Prej këtyre titujve më se shumti ribotime ka pasur vëllimi Përmbledhje vjershash për fëmijë, gjithsej gjashtë: 1966, 1972, 1977, 1980, 1984 e 2001. Ribotimet e këtij vëllimi janë shtypur në 46000 kopje.

Më 2005, ndërkaq, botohet kryevepra e Mjedës Andra e jetës, sipas origjinalit të Vjenës (1917), me parathënie të gjerë (37 faqe) të Anton Nikë Berishës. Librin e ka nxjerrë botuesi Shpresa e Prishtinës dhe ka 63 faqe shtypi. Poema ka 72 strofa katër e gjashtë vargësh dhe 296 vargje.

### PREJ VËLLIMIT TË PARË DERI TE KOMPLETI LETRAR

Mund të thuhet se Ndre Mjeda në Kosovë është prezantuar mirë dhe në kontinuitet. Në mënyrë komplete Mjeda botohet më 1982 me titullin e përbashkët Vepra, në përgatitje të Sabri Hamitit e në botim të Redaksisë së botimeve Rilindja të Prishtinës.

Ky komplet ka tri vëllime, 596 faqe shtypi dhe është botuar në 9000 kopje.

Në vëllimin e parë është përfshirë poezia për të rritur e Ndre Mjedës, në vëllimin e dytë përfshihet krijimtaria letrare për fëmijë: poezi e prozë - rrëfime, artikuj dhe Bibliografia e Ndre Mjedës, hartuar nga Jup Kastrati, ndërsa në vëllimin e tretë gjendet studimi monografik mbi Mjedën, titulluar Mbi veprën poetike të Mjedës të autorit Mark Gurakuqi. Kompletit Vepra është pasuruar me studimin e gjerë të Sabri Hamitit: "Ndre Mjeda poet" (vëllimi i parë f. VII-XXXIX) e me aparaturën e nevojshme studimore.

Sipas kërkimeve tona bibliografike, Ndre Mjeda në Kosovë është prezantuar me shtatë tituj librash: botime, ribotime e komplete veprash, gjatë qarkut kohor 1962-2005, që rrokin 1555 faqe shtypi, me ribotime, në tirazh 79000 kopje. Mbarë poezia e Ndre Mjedës është botuar rëndom si lekturë shkollore.

### TË TJERËT PËR NDRE MJEDËN

Ndre Mjeda ka qenë shpesh edhe objekt studimesh letrare. Me veprën e tij poetike është marrë numër i mirë kritikësh e studiuesisht letrarë: Anton Nikë Berisha, Isak Ahmeti, Rrustem Berisha, Razi Brahimi, Anton Çetta, Ali D. Jasiqi, Mark Gurakuqi, Enver Gjerqeku, Sabri Hamiti, Dedë Berisha, Vehbi Kikaj, Adem Pajaziti, Rexhep Qosja, Mensur Raifi, Ibrahim Rugova, Demush Shala, Dhimiter S. Shuteriqi, Hasan Vokshi, Elhami Nimani, Tajar Hatipi, Shkëlqim Zjari (mbase pseudonim), Xhevat Sylja, Agim Deva etj. Vështrimet e tyre ata i kanë botuar në shtypin periodik: "Rilindja", "Zani i Rinisë", "Shkëndija", "Përparimi", "Pionieri" dhe në titujt e librave: Kritika, Prishtinë, 1972 të Razi Brahimit, Përmbledhje vjershash për fëmijë, Prishtinë, 1966 të Ndre Mjedës, Vjersha dhe poema, Prishtinë, 1966 të Ndre Mjedës, Studime letrare, Prishtinë, 2003 të Sabri Hamitit, Shfletime, Prishtinë, 1972 të Ali D. Jasiqit, Dialogje me shkrimtarët, Prishtinë, 1979 të Rexhep Qosjes, Kritika letrare, tekste, shënime, komente, Prishtinë, 1979 të Ibrahim Rugovës e Sabri Hamitit, Antologji e letërsisë shqipe, Prishtinë, 1954 të Hasan Vokshit, Elhami Nimanit, Tajar Hatipit etj.

Në vështrimet e studimet e këtyre autorëve Ndre Mjeda paraqitet si njëri prej shkrimtarëve tanë më të fuqishëm, një urë midis letërsisë së Rilindjes dhe periudhës së pavarësisë, poet i shquar i traditës sonë letrare, poet i përkushtimit të madh krijues, i dijes dhe i përvojës së pasur letrare e jetësore, poet me ndjenja të fuqishme lirike, mjeshtër i madh i vargut, poet që i beson ardhmërisë së njeriut, demokrat, por edhe bilbil i mbyllur në kafaz e melankolik, njëri ndër tre-katër poetët e parë të letërsisë sonë për fëmijë, poet i ndjeshëm dhe poet tipik i frymës së natyrës shqiptare, poet i perceptimit të realitetit shoqëror të kohës, poeti më vital e më optimist i letërsisë sonë, gjuhëtar i dalluar, njohës i thellë i latinishtes dhe i disa letërsive botërore, patriot e intelektual, teolog, përkthyes, për-

pilues i enigmave e gjëgjëzave (kashe-lasha), njeri me karakter të fortë, njohës i shquar i kulturës sonë, deputet i Opozitës në Kuvendin Kombëtar (1921-1924) etj.

Ndre Mjeda i ka kushtuar rëndësi maksimale edhe anës artistike të poezisë, pra edhe formës. Që herët ai e ka pasur të qartë maksimën "Edhe trupi më i bukur duket i shëmtuar, po që se vishet keq". Poezinë Ndre Mjeda e ka kuptuar si "superart".

### MJEDA I CENSURUAR

Deri më 1962 veprën poetike të Ndre Mjedës në Kosovë e kemi të njohur fare pak dhe kjo përmes ndonjë poezie e fragment poezish e poemash, të botuara në shtypin periodik e në tekstet e ndryshme shkollore.

Shtrohet pyetja: a është prezantuar i censuruar Ndre Mjeda në Kosovë? Po. Bile gjithë deri me botimin e kompletit të tij më 1982.

Kjo hetohet që me botimin e katër strofave të para të poemës së njohur "Vaji i bylbylit" më 1948 me titullin "Bylbyli në pranverë", ku vërehen edhe ndërhyrje e gabime gjuhësore. Ose ta marrin poemën antologjike "Lirija", e cila nuk haset në botimet periodike dhe në tekstet shkollore të konsultuara për këtë punim. Ndërkaq te vëllimi Vjersha dhe poema, Lirija, botohet pa strofën e parë. Apo këngët e poemthit I tretuni, pesë këngë, na dalin të çukitura vargësh e strofash: hiqen nga dymbëdhjetë vargje nga kënga e dytë e katërt dhe e pestë. Dihet Cikli "I tretuni", asht një dhimbje dhe mall që gufon ndër vargje-në pesë këgë të një "të syrgjynosuri" (7). Po ashtu në poezinë Malli për atdhe është hequr strofa e njëmbëdhjetë, përkatësisht vargjet:

Njaz zemri nierit nuk ka qi udhtimin  
Per mirakande merr me u bëgatue;  
Lerg teje, o Shqype, kush lypë gjallimin  
Po do mallkue (8)

Edhe poezia Vera botohet pa strofën e fundit të katërtën (9).

Pra janë hequr vargje e strofa, që asocijnë me gjendjen politike-shoqërore, sociale etj. në Kosovë.  
Mars 2006

# Java e Bibliotekës dhe komunitetet

**BEDRI GASHI**

Në ditët e shënimit për të katërtën herë me radhë të Javës së Bibliotekës në Kosovë, kujtojmë ato të mëhershmet të cilat shënjojnë një nivel të konsoliduar të organizimit, gjatë së cilës Javë prezantohen ide dhe koncepte të përparuara të bibliotekarisë e të kulturës në përgjithësi.

Si veprimtari e përkrahur fuqishëm nga Zyra Amerikane në Prishtinë, ky organizim ka bartur mesazhe të fuqishme miqësie e pune, profesionalizmi e kulture, dije e shkence, arsimit e arti, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të rëndësishëm të zyrave diplomatike në Kosovë, përfaqësuesve politikë e kulturorë të Kosovës, intelektualë, ekspertë të fushës së bibliotekarisë nga ShBA etj. Kemi mësuar shumë nga ato që nuk i kemi ditur dhe kemi zbatuar shumë nga ato që s'i kemi zbatuar më parë.

Ligjëratat, workshopet, sesionet shkencore, promovimet dhe ekspozitat e shumta, të mbajtura në vijimësi, gjatë tri veprimtarive të kaluara të Javës së Bibliotekës në Kosovë, paraqesin fillimin e begatë të një tradite që gjatë tërë një jave promovon vlera esenciale që plotësojnë boshllëkun e një kohe të keqe.

Si përmbledhje e tërë kësaj që u tha më lartë, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe bibliotekat e të gjithë tipave, janë pasuruar më shumë se kurrë më parë me informacione, publikime dhe trajtime të çështjeve më esenciale për



krijimin dhe funksionin e bibliotekave moderne.

Përvojat dhe dijet e transmetuara gjatë këtyre Javëve, kanë pasur ndikim të fuqishëm në ndërtimin e ideve të reja për të projektuar të ardhmen e bibliotekarisë sonë.

Në vigjilje të edicionit të katërt të Javës së Bibliotekës në Kosovë, kujtojmë Deklaratën për bibliotekat dhe lirinë intelektuale të IFLA-s, dhe bindemi se fryma që po ndërton BKUK-ja, jo vetëm gjatë Javës, por edhe pas saj është në përputhje me parimet demokratike të kësaj deklarate. Në Deklaratë, thuhet qartë se "Bibliotekat japin ndihmesën e tyre për zhvillimin dhe mirëadministrimin e lirisë intelektuale, si dhe për ruajtjen e vlerave themelore demokratike dhe të drejtave universale të qytetarëve".

E drejta e secilit për të shprehur mendimin e vet dhe kuptimi për të përkrahur lirinë e shprehjes së tjetrit është ecje përpara e të gjithë neve,

është ndërtim i vlerave të demokracisë e të lirisë. Mbi këtë frymë organizimi dhe manifestimi Java e Bibliotekës në Kosovë do të marrë karakter të rëndësishëm kulturor e bibliotekar, që kalon kufijtë e Kosovës. Në këtë kontekst, është e rëndësishme edhe përfshirja masive e bibliotekave dhe bibliotekarëve të pakicave - një koordinim i pajtueshëm, human e ligjor i proceseve të ardhshme të rrjetit bibliotekar në Kosovë. Qasjet tona janë në shtrirje jashtëzakonisht pozitive dhe premtuese për ndërtimin e të gjitha kapaciteteve tona bibliotekare, qofshin në Graçanicë, në Skënderaj, në Pejë a në Zubin Potok.

Misionet tona bibliotekare janë në funksion të së ardhmes dhe ruajtjes së trashëgimisë së përgjithshme të çdo komuniteti kosovar, që është depozituar dhe, që depozitohet sot dhe që do të depozitohet nesër, prandaj shumë mesazhe mund të përcillen nga ky manifestim i rrallë.

# Pasurimi i koleksioneve të lëndëve mësimore

**URIM SALLAUKA**

**N**ë BKUK për katër muaj rresht janë duke u realizuar një sërë iniciativash e projektsh për zhvillimin e Qendrës së Bibliotekës Universitare. Brenda kësaj qendre pritet të hapen së shpejti disa shërbime të reja, të cilat përkojnë me statusin e Universitetit të Prishtinës dhe me misionin e Bibliotekës Universitare, në mbështetje të arsimit në Kosovë. Një nga këto shërbime do të jetë edhe Koleksioni i Lëndëve Mësimore (KLM). Ky shërbim do ta mbështesë drejtpërdrejt procesin mësimor në Universitetin e Prishtinës.

Duke e parë funksionimin dhe bashkëpunimin e bibliotekave të ndryshme të universiteteve amerikane, si: biblioteka e Kolexhit Simmons, biblioteka e Mount Holyoke-it, biblioteka e Universitetit të Massachusetts (Masachusetts), biblioteka e Amherst-it, Smith-it, etj., me profesorët e këtyre universiteteve, është nxitur ideja që edhe Qendra e Bibliotekës Universitare ta krijojë një këso shërbimi të ri. Me këtë iniciativë të re, secili profesor do të duhej të bashkëpunojë ngushtë me këtë shërbim të QBU-së; në çdo fillim të vitit akademik profesori do t'i parashtronte QBU-së listën e materialeve në planprogramin e tij. Dhe, pastaj, mbetet detyrë dhe obligim i QBU-së që ta blejë ose ta sigurojë nëpërmjet formave të ndryshme të pasurimit këtë

fond. Kjo literaturë vendoset në fondin e Koleksionit të Lëndëve Mësimore, e cila mbetet e vendosur aty për një vit akademik, ose për një semestër. Pastaj, me përfundimin e vitit akademik apo të semestrit, ai koleksion vendoset në fondin e përgjithshëm. Me kërkesën e profesorëve, sipas nevojës, ky veprim përsëritet çdo vit.

Pra, qëllimi kryesor i KLM në Qendrën e Bibliotekës Universitare

shërbim në Koleksionin e Lëndëve Mësimore.

QBU-ja pritet të ketë marrëdhënie shumë të mira me të gjitha fakultetet dhe në veçanti me profesorët, që do ta japin kontributin e tyre, duke i ndihmuar QBU-së, studentëve dhe vetvetes.

Me iniciativën e kësaj qendre, personeli i QBU-së ka kontaktuar gjithë administratën në fakultetet e Universitetit të Prishtinës. Janë aranzhuar takime me dekanë, me prodekanë, me sekretarë dhe me profesorë, si dhe janë kërkuar prej tyre që të jepen informacione për planprogramet mësimore të secilit profesor, duke i identifikuar titujt e librave universitarë, si literaturë e obliguar. Secilit dekanat të UP-së i është

lënë nga një shkresë për këtë çështje. Nga profesorët, deri më tani është arritur të grumbullohen të dhëna për një numër të konsiderueshëm të planprogrameve.

Pas kësaj, QBU do të bëjë përpjekje që menjëherë t'i blejë këto materiale dhe studentët dhe profesorët e Universitetit të Prishtinës të shërbehen me literaturën e nevojshme në kohën e duhur.

Vlerësohet se shërbimi i Koleksioneve të Lëndëve Mësimore të QBU-së është një shërbim shumë i rëndësishëm për mbajtjen në trend të materialit bibliotekar, duke u kushtëzuar nga nevojat dhe kërkesat e të gjithë të interesuarve, duke filluar nga studentët.



është pasurimi me libra të rinj universitarë, që referohen nga profesorët e Universitetit të Prishtinës. Ky shërbim do të jetë në Departamentin e Qarkullimit dhe do të ketë një hapësirë të veçantë për fondin e librave. Gjithashtu, sistemimi i këtyre librave do të jetë i ndarë sipas fakulteteve, degëve të fakulteteve, viteve dhe lëndëve, si dhe do të jetë i lehtë për t'i shërbyer përdoruesit aty për aty. Ky shërbim më së shumti do t'u shërbejë profesorëve dhe studentëve, sepse literatura për të cilën do të kenë më së shumti nevojë do të jetë gjithmonë në

# Të kuptuarit e formatit MARC për njësi bibliografike

**Ç'ËSHTË NJËSIA NË FORMATIN MARC DHE PSE ËSHTË E RËNDËSISHME?**

Sot është e pamundur që të lexohet një revistë biblioteka, të marrësh pjesë në një konferencë për biblioteka, apo edhe vetëm të kesh një bisedë të zakonshme me kolegët e tjerë bibliotekarë dhe të mos dëgjosh shprehjet "formati MARC", "njësitë në formatin MARC", apo edhe "përputhshmëria e formatit MARC me formatet e tjera". Në shumë biblioteka nuk ka pasur ende mundësi personeli i tyre të ndjek kurse të rregullta, në të cilat do të mësonin për tema të rëndësishme të automatizimit të bibliotekave dhe rolin e formatit MARC në këtë proces, pasi dihet që sistemet e automatizuara janë pjesë e rëndësishme në biblioteka.

Ky dokument do të shpjegojë - sa më thjesht që është e mundur - kuptimin se çfarë është një njësi në formatin MARC, si dhe do të japë informacione themelore për ta kuptuar dhe vlerësuar një njësi në formatin MARC.

## ÇKA NËNKUPTJËMË ME FORMATIN MARC?

Ç'është njësia në formatin MARC (lexo: mark)? Me njësi në formatin MARC nënkuptojmë njësi kataloguese të lexueshme nga makina (kompjuteri).

Atëherë çfarë nënkuptojmë me njësi kataloguese të lexueshme nga makina?


Të lexueshëm nga makina (kompjuteri): Me "të lexueshëm nga makina" nënkuptojmë se një lloj i makinës, për shembull kompjuteri, mund t'i lexojë dhe interpretojë elementet të cilat i vejmë në një njësi të katalogim-

it. Në faqet në vijim do të japim shpjegime se ku qëndron rëndësia e kësaj dhe si është e mundur një gjë e tillë.

Njësi kataloguese: "Njësi kataloguese" nënkupton njësinë bibliografike, apo edhe informacionin tradicional të vënë në skeda. Njësi bibliografike përfshin, jo detyrimisht, me një strukturë të caktuar, elementet si vijon: 1) një përshkrim të njësisë së informacionit, 2) përcaktuesen kryesore dhe përcaktueset shtesë, 3) përcaktueset lëndore, dhe 4) numrin e klasifikimit. (Njësitë në formatin MARC zakonisht kanë edhe informacione të tjera shtesë).

1) Përshkrimi: Bibliotekarët i ndjekin rregullat anglo-amerikane të katalogimit, botimi i 2-të i vitit 2002 (AACR2), për të bërë përshkrimin bibliografik të njësisë bibliotekare. Ky "përshkrim" paraqitet në fushat e ndryshme të një skede. Ajo përfshin titullin, pjesën e personave përgjegjës për botimin, botimin, hollësitë për specifikat e botimit, informacione për botimin, përshkrimin fizik, vërejtjet dhe numrat standard.

2) Përcaktuesja kryesore dhe përcaktueset shtesë: AACR2, po ashtu, përmban rregulla të cilat i përcaktojnë "pikat e qasjes" (përcaktueset) në një njësi (të cilat shpesh i quajmë "përcaktues kryesore" dhe "përcaktues të tjera shtesë"), dhe formën që këto përcaktues duhet të marrin. Këto për-



caktues përcaktojnë mënyrën se si përdoruesi mund të nxjerrë informacionin duke kërkuar katalogun e një biblioteke.

Me fjalë të tjera, rregullat në AACR2 përdoren për t'u gjetur përgjigje pyetjeve si: Për këtë libër, a duhet të ketë përcaktues të një apo më shumë autori apo një e më shumë titujsh në katalog? A duhet të shënohet titulli i koleksionit (serisë)? Si duhet të shkruhet emri i autorit? A është vetë titulli përcaktues kryesore në këtë rast (nëse nuk ka autor)?

3) Përcaktueset lëndore (përcaktueset shtesë lëndore): Bibliotekari përdor Listën e përcaktuesve lëndor Sears, Përcaktueset lëndore të Bibliotekës së Kongresit, si dhe lista të tjera standarde për të përzgjedhur një përcaktues nën të cilën do të vendoset njësi kataloguese. Përdorimi i një liste



zyrtare dhe të miratuar për përdorim ka rëndësi të madhe për standardizim, dhe për të siguruar që të gjitha njësitet kataloguese në një lëmi të caktuar të gjenden nën përcaktuesen e njëjtë dhe po ashtu në vendin e njëjtë në katalog.

Për shembull, lista e përcaktuesve lëndore tregon se të gjitha librat, që bëjnë fjalë për gurët e çmuar, t'u përcaktohet përcaktuesja lëndore 'Gurët e çmuar'. Duke përdorur këtë përcaktuese të autorizuar, eliminohet mundësia që disa libra të radhiten nën përcaktuesen 'Gurët e çmuar' e disa nën përcaktuesen 'Xhevahiret'. Edhe nëse një libër titullohet Informacione të përgjithshme për Xhevahiret, libri përsëri do të radhitet nën përcaktuesen 'Gurët e çmuar'. Në atë mënyrë, të gjitha librat në një lëndë të caktuar do të radhiten në një vend në katalog, kështu që përdoruesi do të mund t'i gjejë me lehtësi. Përdoruesi nuk do të ketë nevojë që të mendojë gjatë dhe të imagjinojë se cilat janë sinonimet e fjalës të cilën ai dëshiron ta kërkojë.

4) Numri i klasifikimit: Bibliotekari përdor tabelën e klasifikimit sipas Djuit apo atë të Bibliotekës së Kongresit për të përzgjedhur numrin e klasifikimit për njësinë kataloguese. Qëllimi i numrit të klasifikimit është që t'i vendosë njësitet e një lëndë ta caktuar së bashku, afër njëra-tjetrës, në një raft të bibliotekës. Shumica e njësive pastaj nënradhiten në mënyrë alfabetike sipas autorit. Pjesa e dytë e numrit të klasifikimit paraqet emrin e autorit, duke ndihmuar në këtë nënradhitje.

#### PSE NA DUHEN NJËSITË NË FORMATIN MARC?

Pse kompjuteri nuk mund t'i lexojë njësitet e autorizuara të krijuara në skedë?

Informacioni i njësive të krijuara në skedë letre nuk mund të futet thjesht në kompjuter dhe të bëhet menjëherë pjesë e katalogut të automatizuar.

Kompjuteri ka nevojë për metoda dhe mënyra me anë të të cilave i interpreton informacionet që gjenden në një skedë letre të një njësie kataloguese. Njësitet në formatin MARC përmbajnë një udhërrëfyes të interpretimit të të dhënave të krijuar në të, të njohura si "shenja orientuese", para secilës pjesë (element) të informacioneve të një njësie bibliografike.

Vendi në të cilën vendoset se cila pjesë e njësive bibliografike (autori, titulli, numri i klasifikimit, etj.) quhet "fushë." Struktura e njësive në formatin MARC përmban nganjëherë një numër të fushave me gjatësi të kufizuar dhe kështu ato fusha përmbajnë një numër të kufizuar të karaktereve.

Megjithatë, për të mundësuar një katalogim ashtu si duhet të librave dhe

njësive të tjera bibliotekare, struktura tjetër e njësive bibliografike mundëson një numër të pakufizuar të fushave dhe të gjatësive të tyre. Ky fleksibilitet është i nevojshëm pasi jo të gjithë kanë gjatësi të njëjtë (Kështjella kundrejt Historia e letërsisë botërore). Madje disa libra janë edhe pjesë e një koleksioni apo serie, të cilat kërkojnë të kenë një fushë, e cila do të përmbajë atë informacion, ndërsa të tjerat nuk kanë nevojë për një informacion të tillë. Për më tepër, materialet audiovizuale e kanë më të gjatë përshkrimin fizik (5 filma: sd., me ngjyra; 35 mm. + doracakun) se sa shumica e librave (403 f. : me ilustrime. ; 22 cm.).

Kompjuteri nuk mund të hamend se një lloj i caktuar i informacionit fillon dhe mbaron në pozitë të njëjtë në

"Shenjat orientuese"	Informacioni
Përcaktuesja kryesore, emri personal me vetëm një mbiermër	Anronsky, Jim.
Fusha e titullit dhe e personave përgjegjës, përzgjedh vetëm informacionin e titullit si përcaktuese shtesë të titullit "Ra..." Informacioni i titullit: Personal përgjegjës	Raccoons and ripe corn/ Jim Arnosky.
Fusha e ribotimit Informacioni për ribotim:	Botimi i 1-të.
Fusha e botimit, e shpërndarjes, etj. Vendi i botimit: Data e botimit:	New York: Lathrop, Lee & Shepard Books, C1987.
Fusha e përshkrimit fizik: Faqet: Ilustrimet: Madësia	25 f. ilustrimet me ngjyra. 26 cm.
Fusha e vërtetjeve: Përmbledhja	Rakunët e uritur festojnë natën në fushën me misër të pjekur.
Përcaktueset shtesë lëndore, nga lista e përcaktuesve lëndore për fëmijë të Bibliotekës së Kongresit: Përcaktuese tematike:	Raccoons.
Numër lokal i klasifikimit:	5999.74 ARN
Numër lokal i barkodit	8009
Çmimi:	\$15.00

çdo njësi bibliografike. Për shembull, fusha e personave përgjegjës nuk fillon gjithmonë në pozitën e 145-të të një njësie bibliografike dhe të mbarojë pastaj në pozitën e 270-të. Prandaj, secila njësi në formatin MARC përmban një "pasqyrë të vogël të përmbajtjes" të formuluar në bazë të standardeve të paracaktuara.

"Shenjat orientuese" të informacioneve: Kompjuterit duhet t'i ofrohet ndihmë nëse dëshirojmë që ai t'i lexojë dhe interpretojë si duhet njësitë bibliografike të krijuara në formatin MARC. Tabela e mëposhtme e tregon informacionin që duhet ta bartin këto "shenja orientuese".

Po qe se një njësi bibliografike është krijuar si duhet dhe është ruajtur në kompjuter, atëherë mund të krijohen dhe shkruhen programe kompjuterike, të cilat mund ta shfaqin informacionin ashtu si duhet në ekran të kompjuterit apo edhe të shtypin skeda prej letre. Po ashtu, mund të krijohen programe të ndryshme, të cilat do të mundësojnë kërkimin dhe nxjerrjen e rezultateve për lloje të caktuara të informacioneve brenda fushave specifike. Programet kompjuterike mund të shfaqin po ashtu edhe lista të njësive të caktuara të cilat i përmbushin kriteret e caktuara të një kërkimi të veçantë.

Krahasimi i njësisë së njëjtë, ku paraqitet me tekst dhe me tage në formatin MARC, paraqet një shembull të mirë të përparësive të formatit MARC 21. Këtu kemi të bëjmë me hapësirën që zënë këto informacione në bazën e të dhënave të bibliotekës. Shih tabelat më lart. Formatin MARC 21 përdor taget "670" "Sa" dhe "Sb" "Sc" për t'i dalluar fushat veç e veç në vend të ruajtjes së fjalëve "fusha e botimit", "vendi i botimit", "emri i botuesit" dhe "data e botimit" për secilën njësi bibliografike. Ky standardizim mundëson përdorimin më efikas të kompjuterëve, duke kursyer sa më shumë hapësirë në të.

Pse një standard? Ju mund të krijoni metodat tuaja të organizimit të

"Shenjat orientuese"	Informacioni
100 1# 2a	Armstrong, Jim.
245 10 2a	Kenneth and ripe north /
	Jim Armstrong.
250 ## 2a	Botimi i 1-të.
260 ## 2a	New York :
	Lothrop, Lee & Shepard Books,
	c1987.
300 ## 2a	25 f., 1
	ilustrimet me ngjyrë :
	26 cm.
250 ## 2a	Katibët e Uritar festojnë natën në fushën me miatë të
	gjeokur.
650 #1 2a	Kombosia.
900 ## 2a	599.74 AA6
901 ## 2a	8009
903 ## 2a	815.00

informacioneve të njësive bibliografike, por në atë mënyrë do ta izoloni bibliotekën tuaj, do t'i kufizoni mundësitë, dhe do t'i krijoni vetes suaj shumë më shumë punë. Duke e përdorur formatin standard MARC mundësoni parandalimin e dyfishimit të punës së njëjtë dhe u mundësoni bibliotekave që t'i përdorin informacionet e njëjta të njësive bibliografike në mes tyre. Përzgjedhja e formatit MARC u mundëson bibliotekave të marrin dhe përdorin informacionet e njësive bibliografike, të cilat janë të parashikueshme dhe të besueshme. Po qe se një bibliotekë do të zhvillonte një sistem "të vetin", që nuk do të përdorte njësitë në formatin MARC, nuk do të paraqiste ndonjë përparësi apo përparim në fushën e industrisë së standardeve, qëllimi i të cilave është komunikimi i informacioneve sa më gjerë që të jetë e mundur.

Përdorimi i formatit MARC u bënë të mundur bibliotekave që të shfrytëzojnë sistemet e automatizuara bibliotekare, të cilat shërbejnë për menaxhimin e veprimtarisë bibliotekare. Shumica e sistemeve të tilla u përshtaten nevojave të çdo lloji bibliotekë dhe janë të projektuara në atë mënyrë që të punojnë me formatin MARC. Këto sisteme mirëmbahen nga shitës të ndryshëm komercial, kështu që bibliotekat mund të përfitojnë nga teknologjia e fundit. Formatin

standard në MARC po ashtu mundëson që bibliotekat të mund të zëvendësojnë një sistem me një tjetër duke garantuar që informacionet e ruajtura në këtë format të përputhen përsëri me sistemin e ri.

MARC 21: Për shkak se Biblioteka e Kongresit ka koleksione të mëdha, si dhe programe bashkëpunimi me biblioteka të tjera, formati MARC21 shërben si burim kryesor i njësive bibliografike për katalogët në ShBA dhe në nivel ndërkombëtar. Në kohën kur Biblioteka e Kongresit filloi të përdorte kompjuterë në vitet e 1960-ta, ajo e shpiku formatin bibliografik në MARC të Bibliotekës së Kongresit, sistem që përdorte numra të shkurtër, shkronja dhe simbole brenda vetë njësisë bibliografike për të dalluar lloje të ndryshme të informacioneve brenda asaj njësie. Formatin fillestar MARC i Bibliotekës së Kongresit u zhvillua në formatin MARC 21, i cili është bërë standardi i përdorur nga shumica e programeve kompjuterike të bibliotekave. Formatin MARC 21 për njësitë bibliografike, si dhe të gjitha dokumentacionet zyrtare për formatin MARC 21, mirëmbahet nga Biblioteka e Kongresit. Ajo është botuar si Formatin MARC 21 për njësitë bibliografike (MARC 21 Format for Bibliographic Data).

*Përktheu nga origjinali:  
Besim J. Kokollari*

# Rëndësia e klasifikimit lëndor

/ vijon nga numri i kaluar /

## EMËRTIMET LËNDORE TË SHPREHURA ME EMRA TË PËRVEÇËM

Emërtimet Lëndore të shprehura me emra të përvëçëm ndahen në:

1. Emra të personave;
2. Emra të organizatave;
3. Emrat të grupeve etnike, kombësitë etj.;
4. Emrat gjeografikë.

1. Emrat e personave - përdoren si EL (Emërtime lëndore) për biografitë, kritikën, botimet përkujtimore, bibliografitë, veprat letrare kushtuar një personi. Forma e emrit, ndiqet sipas rregullave të AACR2 d.m.th. sikur të përcaktuesja kryesore e shprehur me autor. Në Tregues janë një numër i kufizuar emrash, dhe kataloguesi mund t'i shtojë ata sipas nevojës. Kryesisht, duhet të ndiqet shembulli i Shekspirit për t'i shtuar edhe emërtimet e tjera lëndore për autorë. Kështu veprohet dhe për emrat e familjeve. Ndërsa, për emrat e karaktereve të letërsisë, pas emrit, në kllapa, vendoset cilësori (karakter letrar) ose (karakter i trilluar), p.sh. Tarzani (karakter i trilluar).

Në MARC 21, i cili po praktikohet në BKUK, fushat 6XX janë përcaktuar për klasifikimin lëndor. Kështu, po marrim një shembull të EL të shprehur me emër personi.

### Shembull:

Titulli: *Poezia e Lasgush Poradecit në kontekstin e poezisë evropiane* / Hysen Matoshi

EL në MARC 21:

600 14 \$ a Poradeci, Lasgush  
\$ x Kritika, interpretimi.

2. Emrat e organizatave - përfshihen organizata, shoqata, institute, agjenci shtetërore, firma tregtare, konferenca, ekspedita etj. Krahas emrit mund të përdoren dhe cilësorë.

### Shembull:

Titulli: *Gjimnazi i Mitrovicës* / Fazli Hajrizi

EL në MARC 21:

650 #4 \$ a Gjimnazi i Mitrovicës (Kosovë)  
\$ v Biografi.

Kataloguesi mund të shtojë emërtime në tregues sa herë të jetë nevoja e përdorimit të tyre. Por, gjithsesi futja e termave në tregues të emërtimeve lëndore duhet konsultuar me standardin. Edhe ngjarjet historike, emrat e kafshëve dhe bimëve të veçanta, emrat e çmimeve, të festave, të festivaleve etj., në klasifikimin lëndor përdoren si emra të përvëçëm.

### Shembull:

Titulli: *Çështja e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore* / Izber Hoti

EL në MARC 21:

650 #4 \$ a Lufta Botërore, 1939-1945  
\$ z Kosovë.

Këtu duhet t'i shtohet edhe një EL për Kosovën, por do ta sqarojmë te EL të shprehura me emra gjeografikë.

3. Emrat e grupeve etnike, kombësitë etj. - në tregues janë në numër të kufizuar, mirëpo ata shtohen gjatë përdorimit. P.sh.: Shqiptarët; Arabët; Italianët; etj.

### Shembull:

Titulli: *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913* :

(*Dokumente*) / Zekeria Cana

EL në MARC 21:

650 #4 \$ a Shqiptarët  
\$ x Historia-Dokumente.

Këtu shtohen, po ashtu, edhe emërtime të tjera për ta klasifikuar saktësisht këtë libër.

Edhe sistemet filozofike, fetë, etj., janë emërtime të veçanta në tregues, p.sh.: Budizmi; Konfucianizmi; Krishtërimi etj.

4. Emrat gjeografikë - në tregues dalin si emërtime kryesore ose pjesë e një emërtimi të përbërë. P.sh. :

Shqipëria - Historia

Zbukurimi i mjedisit - Kosovë

Kurse, emrave të provincave, qyteteve, territoreve brenda një vendi u vendoset emrin e vendit në kllapa. P.sh.: Gjeneva (Zvicër)  
Venediku (Itali)

### Shembull:

Titulli: *Të papunët e Marienthalit* : (*studim socio-demografik*) / Marie Jahoda ...

[et al.]

EL në MARC 21:

651 #4 \$ a Marienthal (Gjermani)  
\$ x Gjendja sociale.

Emrat e vendeve vendosen ashtu si shqiptohen në shqip. Ndërkaq, kur forma e emrit nuk është e njohur në gjuhën shqipe, atëherë përdoret forma origjinale. Në Treguesin e Emërtimeve Lëndore nuk gjenden të gjithë emrat gjeografikë, andaj kataloguesi i krijon vetë ata, sipas nevojës. P.sh.: Bjeshkët e Nemuna (Kosovë); Deti Adriatik, etj.

Edhe emrat e lagjeve dhe njësi të tjera, ndërtesa, rrugë, parqe, ura, monumete, formohen me emrin e tyre

duke i shtuar emrin e qytetit dhe të shtetit në kllapa. Përdoren në gjuhën e vendit ku ndodhen. P.sh.: Rruga "Nëna Terezë" (Prishtinë, Kosovë); Pont -Neuf (Paris, Francë).  
Shembull:

Titulli: *Shkodra në shekullin XV / Lulzim Lajçi*

EL në MARC 21:

651 #4 \$ a Shkodra (Shqipëri)

\$ x Historia

\$ x Principata e Shkodrës. Balshët.

### NËNNDARJET

Në Treguesin e Emërtimeve Lëndore janë katër tipa të nënndarjeve: lëndore, gjeografike, kronologjike dhe të formës. Gjithashtu, ekzistojnë edhe nënndarjet e lira.

**Nënndarjet lëndore** - paraqesin një aspekt të emërimit kryesor, por jo vend, kohë ose formë. P.sh.:

Sociologjia - Metodologjia

Shekspir, Uiliam - Karakteret

Zemra - Sëmundjet - Diagnoza

Njëri nga këta shembuj, në MARC 21, gjegjësisht në programin e automatizuar Aleph 500 do të dukej kështu:

Titulli: *Diabeti dhe zemra / Gani Bajraktari*

EL në MARC 21:

650 #4 \$ a Zemra

\$ x Sëmundjet

\$ x Diagnoza.

**Nënndarjet gjeografike** - Të gjitha emërtimet nuk mund të ndahen gjeografikisht në tregues. Ato subjekte që mund të ndahen gjeografikisht kanë përbri shënimin (Mund të ndahet gjeografikisht). P.sh.:

Ekologjia (Mund të ndahet gjeografikisht)

Shembull:

Titulli: *Ekologjia e bimëve : praktikum / Esat Hoxha, Behxhet Mustafa*

EL në MARC 21:

650 #4 \$ a Ekologjia

\$ z Kosovë.

Kurse, ato subjekte që nuk mund të ndahen gjeografikisht kanë përbri shënimin (Nuk ndahet gjeografikisht).

P.sh.:

Marrëdhëniet ekonomike ndërkom-bëtare (Nuk ndahet gjeografikisht)

Shembull në MARC:

Titulli: *Marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet anëtare të Bashkimit Ekonomik Europian / Sinan Tafaj*

EL në MARC 21:

650 #4 \$ a Marrëdhëniet ekonomike ndërkom-bëtare.

Këtij shembulli duhet t'i shtohen edhe EL të tjera si subjekte kryesore.

**Nënndarjet kronologjike** - Nënndarja kronologjike përdoret më shpesh të shkencat shoqërore dhe veçanërisht të historia. P.sh.:

Shqipëria - Historia

- Deri në vitin 1912

- Paleoliti deri në shek. 7 të e. r.

- Ilirët etj.

Te disa vende si p.sh. Shqipëria - Historia është formuar EL në Tregues në konsultim me historianë dhe mund të krijohen nënndarje të tjera me kalimin e kohës. Kurse te disa subjekte nënndarjet kohore janë të përcaktuara. P.sh.:

Arti modern - Shekulli 19

Arti modern - Shekulli 20

Mirëpo, disa EL shprehin njëkohësisht veçori lëndore dhe kronologjike. P.sh.:

Arti antik

Arti barok

Arti mesjetar

Arti romanes

Edhe një datë e fillimit dhe e mbarimit ose edhe vetëm data e fillimit të një ngjarjeje, si emërtime mund të nëndahen. P.sh.:

Lufta Botërore 1914-1918

Politika botërore 1945-

Pastaj, periudhat historike, ngjarjet e shënuar të ndjekura nga një datë, si emërtime, mund të pasohen nga një nënndarje. p.sh.:

Shqipëria - Historia - Shek. 16-17

Shembull në MARC:

Titulli: *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë /*

Injac Zamputi

EL në MARC 21:

651 #4 \$ a Shqipëria

\$ x Historia

\$ y Shek. 16-17.

**Nënndarjet e formës** - tregojnë formën fizike ose bibliografike të veprës, si:

- Bibliografi

- Harta

- Enciklopedi

- Vepra të ilustruara

- Programe kompjuteri

Çdo emërtim kryesor ose edhe emërtim me disa nënndarje mund të shoqërohet me nënndarje të formës. P.sh.:

Arti mesjetar - Kongrese

Minoritetet - Kosovë - Bibliografi

Gjuha shqipe - Gjuha letrare - Tekste për shkolla fillore

Shembull në MARC:

Titulli: *Gjuha shqipe 8 : Gramatikë-Drejtshkrim-Gjuha e folur dhe e shkruar / Bahri Beci*

EL në MARC 21:

650 #4 \$ a Gjuha shqipe

\$ x Gjuha letrare

\$ v Tekste për shkolla fillore.

Ky shembull mund të ketë edhe Emërtime Lëndore të tjera.

Mirëpo, mund të përdoren edhe më shumë nënndarje forme në një emërtim kryesor dhe vendosen njëra pas tjetrës. P.sh.:

Shqipëria - Industritë - Statistika - Periodikë

- vijon -

Përgatiti: Hazbije QERIQI

# Ruajtja dhe spastrimi i fondit bibliotekar

**P**ër bibliotekarët e fillimshkullit 21, krahas vrapit për zhvillim të shpejtë në shkencat informative, preokupim është edhe ruajtja dhe spastrimi i fondeve bibliotekare. Që të mundësohet shqyrtimi paralel i ruajtjes dhe i spastrimit të fondit, do të duhej të kemi parasysh pyetjet kryesore që ndihmojnë shtjellimin e kësaj problematike. Disa prej pyetjeve janë:

1. Çfarë kushtesh ndihmojnë jetëgjatësinë e burimeve bibliotekare?
2. Çfarë masash marrin bibliotekat që të sigurohen që përdorimi i madh i materialeve nuk do t'i çojë deri te rreziku i dëmtimit të materialeve?
3. Si mund të ruhen materialet digjitale?
4. Pse është i rëndësishëm planifikimi për raste rreziku dhe si bëhet ai?
5. Cila është ideja gjithëpranueshme për spastrim (hurrje)?
6. Si vendoset se për cilat revista do të ndërpritet parapagimi?
7. A vjen në shprehje spastrimi edhe i burimeve elektronike?


Ndoshta duket e çuditshme që paralelisht të shqyrtohen ruajtja (d.m.th. organizimi i ruajtjes sa më gjatë i burimeve të informacionit) dhe spastrimi i fondit, mirëpo, këto të dyja janë alternativa të njëra-tjetrës. Kjo ndodh për shkak se të dyja këto aktivitetet merren me vlerësimin e jetëgjatësisë (të qëndrueshmërisë) së materialeve dhe do të vlerësohet se: a do të jetë një titull gjithmonë i kërkuar; ose - a është botuar për të plotësuar nevojat e hartuara, të cilat tashmë janë pjesë e së kaluarës? Këto dy fusha kanë emërues të për-

bashkët - vendim-marrje profesioniste për vlerën e materialit. Kjo punë, pra ruajtja dhe spastrimi i fondit bibliotekar kryhet njëkohshëm; e për-bashkët e këtij aktiviteti është çështja e shpenzimit të kohës që është e nevojshme që këto punë të kryhen.

Vendimi për të bërë spastrim të fondeve mund të pritet jo këndshëm, sidomos

jetëshkurtra do t'i vërshojnë raftet dhe do t'i ngufasin katalogët (joelektronik), duke vështirësuar gjetjen e titujve të rinj. Kështu që biblioteka do të shndërrohet në një depo bibliografike.

Edhe ruajtja edhe spastrimi vinë në fund të "ciklit jetësor" të informacioneve bibliotekare (shih fig)



nga bibliotekarët, të cilët tërë jetën e tyre profesionale ia kanë kushtuar mbledhjes, e jo largimit; sipas mendimit të tyre, me largimin e materialeve, fitohet vetëm pak hapësirë e lirë nëpër raftet, e cila shumë shpejt pastaj mund të plotësohet. Për këtë arsye, shumë bibliotekarë mendojnë që është më mirë (e më lehtë), që materiali i siguruar njëherë të mbetet gjithmonë në dispozicion. Një mendim i tillë i bibliotekarëve është i paarsyeshëm dhe pasojë afatgjate e kësaj pakujdesie është që materiali me vlerë të qëndrueshme ndoshta nuk do të jetë i mbrojtur, derisa grumbujt e njësive me vlera të pakta ose

Këto janë punët përfundimtare në strukturën e menaxhimit të burimeve të informacionit në biblioteka. Për ruajtjen duhet të fillojmë nga disa definicione; ruajtja është term i gjerë dhe nënkupton të gjitha aktivitetet lidhur me mbledhjen e burimeve dhe me ruajtjen e përmbajtjes informative. Ajo qëndron përball konservimit, e cila i përket tretmanit të njësive fizike për të vazhduar jetën e vlefshme të tyre (dhe restaurimit - që nënkupton përpunimin e materialit të dëmtuar me qëllim që të kthehet në gjendje sa më të përafërt me origjinalin). Për këtë shkak,

ruajtja është njëkohësisht term i gjerë dhe fushë e gjerë, përkundër konservimit që është fushë e veçantë dhe specifike.

As ruajtja nuk ndodh vetvetiu, sikurse që nuk ndodh as menaxhimi i fondeve në përgjithësi. Ruajtja duhet të menaxhohet. Dhe, problemi kryesor në këtë fushë është i njëjtë që njëqind vjet: sa më suksesshëm që grumbullohet dhe promovohet material i rrallë, shumë lexues dëshirojnë të arrijnë tek ai material, dhe sa më shumë që të shfrytëzohet, aq më tepër i nënshtrohet rrezikut. Me qëllim të parandalimit të kësaj, duhet aplikuar një varg i tërë strategjish menaxhuese që lidhen ngushtë me kushtet hapësinore për vendosjen e materialit bibliotekar.

Qysh moti është pranuar që materiali bibliotekar duhet të ruhet nëpër depo me kushte të përshtatshme klimatike, në temperaturë prej 20°C, plus ose minus 20°C, me lagështi relative prej 50 %, plus ose minus 5%. Pa dyshim, këto kushte janë të përshtatshme për pjesën më të madhe të fondeve, por porositë kryesore nuk i vënë në pah plotësisht rregullat themelore që kushtet klimatike duhet të jenë stabile, që të sigurohet ruajtja afatgjate. Nga ndryshimet e mëdha ose lëkundjet e temperaturës ose të lagështisë relative më tepër do të dëmtohen materialet me përbërje organike, (siç është p.sh. shtypi), se sa deponimi i gjatë jashtë kufizimeve. Si shembull i marrim mjetet e klimës. Në shumë institucione, ato vendosen për shkak të personelit dhe jo për ruajtjen e materialit. Kështu që në hapësirë me siguri do të jetë tepër nxehtë dhe lagësht, sepse njerëzve të cilët qëndrojnë aty do t'iu vijë ftohtë të punojnë në temperaturë prej 20°C (por, edhe kjo temperaturë e është vetëm një kompromis; është vërtetuar se letrës më së shumti i përgjigjet temperature prej 18°C). Për shumicën e njerëzve lagështia relative e ajrit prej 50% është e pamjaftueshme. Edhe më keq do të jetë, nëse objekti i klimatizuar është për një periudhë

kohore i zbrazët, për shembull gjatë vikendit apo gjatë festave, pajisjet zakonisht shkyçen për arsye të kursimit, p.sh. në një bibliotekë universitare të Australisë klimatizimi është ndërprerë gjithmonë gjatë pushimit të Vitit të Ri dhe Kërshëndellave, kur në Australi është verë. Sikur ajo ndërtesë e madhe të mos kishte fare klimatizim, ndryshimet graduale relativisht të ngadalshme të temperaturës dhe lagështisë sezonale do të ishin shumë më pak të dëmshme për fond.

Çështje tjetër është edhe mbrojtja nga rrezet e diellit. Janë të paktë ata të cilët nuk kanë libra me kopertina të zbehuara për shkak të ekspozimit të tepërt të tyre në rreze të diellit. Çdo dritë e dëmton materialin, kështu, do të ishte ideale që librat të deponohen në vend të errët dhe dritat të ndizen vetëm gjatë përdorimit të materialit, pra ky është edhe një shembull ndërmjet nevojave për përdorim dhe ruajtjes. Materiali fotografik, sidomos duhet të deponohet në vend të errët me qëllim të zgjatjes së afatit. Kjo vlen për sllajdet, negativët, mikrofilmat etj.

Pasi që komoditeti njerëzor nuk është më i rëndësishmi sipas pikëpamjeve për ruajtjen e materialit, kushtet klimatike duhet të përcillen rregullisht. Instrumentet për këtë qëllim mund të huazohen, por më së miri është të punësohet konservuesi, i cili në mënyrë profesionale do të vlerësojë bibliotekën, ose së paku hapësirën e depos. Kështu zbulohen pjesë fushash ose hapësirash të ndjeshme, e pastaj mund të zhvillohen plane për rregullimin e tyre. Për një kohë më të gjatë, nëse mendohet për objektet të ri, do të ishte mençuri që nevojat e fondit të merren parasysh, së bashku me nevojat e personelit dhe lexuesve.

Meqenëse kërkesat, të cilat paraqesin ruajtjen dhe përdorimin shpesh ndryshojnë, njëra nga zgjidhjet është kopjimi i materialit në një formë tjetër, për shembull në mikrofilm. Përdoruesve iu jepet kopja, kurse origjinali deponohet në kushte ideale. Shembull klasik i një trajtimi të tillë

janë gazetat ditore. Pasi që ato shtypen në një material të dobët e më të lirë, sigurisht që do të dëmtohen gjatë përdorimit, kështu që shumica e bibliotekave ua japin lexuesve kopjet e mikrofilmuara në vend të origjinalit. Kjo i ka disa përparësi:

- Mund të përpunohet nga një master kopje e të gjitha gazetave, të cilat konsiderohen të rëndësishme për t'u ruajtur, e prej saj mund të bëhen kopje të tjera për përdorim;
- Kopjet që dëmtohen gjatë përdorimit mund të zëvendësohen lehtë;
- Mikrofilmat janë përafërsisht më jetëgjatë, nëse ruhen si duhet;
- Teknika e nevojshme për lexim dhe kopjim të mikrofilmave është përafërsisht e thjeshtë dhe në të nuk do të ndikojnë shumë ndryshimet teknologjike;
- Ka pak lexues, të cilët, vërtet, kanë nevojë të shohin origjinalin (edhe pse askush nuk dëshiron të shfrytëzojë mikrofilmat), të cilët mund të deponohen në kushte ideale.

Prandaj, mikrofilmi për një kohë të gjatë është pranuar si zgjidhje kryesore për ruajtjen e përmbajtjes informative, sidomos kur kemi të bëjmë - sikurse te gazetat - me ndonjë prodhim fizik të kualitetit të dobët.

Teknologjitë e reja, siç është CD ROM, shpesh janë viktime të një teknologjie të vjetruar. Për këtë janë të vetëdijshëm arkivistët profesionistë, dhe lidhur me këtë, bibliotekaria ka shumë çka për të mësuar nga arkivistika. Edhe pse në varshmëri të madhe nga teknologjia, përparësitë e përpunimit të kopjeve digjitale të vjetruara, të rrezikuara ose origjinaleve të rralla, janë të dukshme. Ky është veprimi më i përshtatshëm, p.sh. për sajtet, që është treguar në shumë biblioteka. Në të ardhmen do të ketë edhe më shumë kopje të tilla - ato do të posedojnë përparësitë për qasjes globale dhe numër më të madh të përdoruesve në të njëjtën kohë - dhe do t'ua zënë vendin mikrofilmave jopopullarizues.

*Përgatiti:* Bahtie Gërbeshi Zylfiu

# Zhvillimi i Bibliotekës Universitare

ELHAME BUZUKU  
BARLET BERISHA

**B**iblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me Zyrën Amerikane në Prishtinë, me Institutin për Trajnim dhe Zhvillim në Amherst, me Kolegjin Simmons në Boston dhe me Departamentin e Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka përzgjedhur 9 kandidatë për shkollim dhe trajnim në Amerikë në fushën e bibliotekarisë.

Në trajnimin 17-javësh (gusht - dhjetor 2005), projekti ka përfshirë pjesën teorike - përcjelljen e ligjëratave në Kolegjin Simmons në Boston, si dhe pjesën praktike - vëzhgimin dhe pjesëmarrjen e të gjithë kandidatëve nëpër bibliotekat e ndryshme të atij rajoni. Qëllimi i trajnimit ishte aftësimi i stafit për zhvillimin e shërbimeve informative, menaxhimi i bibliotekave qasjen në bazat e të dhënave elektronike, si dhe aftësimin në mënyrë profesionale - për ndihmë përdoruesve në qasjen në informacionin e nevojshëm.

Të gjithë pjesëmarrësit kanë ndjekur ligjërata në tri lëndë në Kolegjin Simmons në Boston. Gjithsej janë vijuar 8 lëndë: Shërbimet e Referencës dhe Informimit, Vlerësimi i Shërbimit të Informimit, Teknologjia Informative për Profesionistë, Organizimi i Informacioneve (katalogimi),

Principet e Menaxhimit, Zhvillimi dhe Menaxhimi i Koleksioneve, Menaxhimi i Ruajtjes dhe Konservimit në Biblioteka dhe Arkiva dhe Hyrje në Metodat dhe Shërbimet Arkivore. Në pjesën teorike, kandidatët kanë qenë të ndarë në grupe dhe kanë përcjellë nga disa lëndë - të ndryshme nga njëri-tjetri, në mënyrë që të përfitohen njohuri të sa më shumë lëndëve.

Pjesa praktike e punës - një herë në javë, është kryer në katër biblioteka të rajonit të Amherstit; po ashtu një herë në javë është bërë praktikë në biblioteka të universiteteve të mëdha në Boston dhe Brandeis, ku, ndër të tjera, pjesëmarrësit kanë bërë praktikë dy ditë në bibliotekën e Harvardit, dhe dy ditë të tjera në bibliotekën e MIT-së, (Institutin e Teknologjisë së Shtetit Massachusetts). Pra, pjesëmarrësit kanë qenë të shpërndarë në këto biblioteka me qëllim që të marrin përvoja të ndryshme.

Përpos, Julie Hooks Davis, Drejtoreshë Ekzekutive e Institutit për Trajnim dhe Zhvillim, Terry Plum, Drejtor Administrativ i Projektit dhe përfaqësues e mësimdhënës në Kolegjin Simmons në Boston, në javën e fundit kanë qenë të ftuar të marrin pjesë në projekt edhe Dr. Kenet Oberembt - ish-drejtori i përkohshëm i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, njëkohësisht autor i planit Strategjik për Bibliotekat e Kosovës, si dhe Dr. Sali Bashota, drejtor i tanishëm i po këtij institucioni. Me ta është diskutuar

për gjithë atë që është bërë dhe punuar gjatë kësaj kohe dhe për perspektivat pas përmbylljes së fazës së parë të projektit, që ka përfshirë trajnimin në SHBA.

Si rrjedhim, grupi ka dalë me projekt-propozimin se si të krijohet Qendra e Bibliotekës Universitare, dhe në këtë kontekst është bërë një plan veprues, i cili tashmë ka filluar të realizohet.

\*\*\*

Qendra e Bibliotekës Universitare ka për qëllim që të krijojë fondet e hapura për studentë. Koleksioni i Bibliotekës Universitare do të jetë drejtpërdrejt material që do t'u shërbejë studentëve në studimet e tyre dhe do të jetë i hapur, në mënyrë që studentët vetë të gjejnë materialet. Po ashtu, ata do të mund ta huazojnë këtë material në shtëpitë e tyre. Ky fond do të futet në katalogun elektronik dhe studentët mund të shohin nga interneti, prej kudo qofshin ata, se çfarë materiali mund të gjejnë në Bibliotekën Universitare. Po ashtu, studentëve do t'u ofrohen shërbime të mira informuese, duke iu ndihmuar të gjejnë edhe informacione në burimet elektronike përmes internetit.

Tashmë është duke u punuar në ndarjen e fondeve të Qendrës së Bibliotekës Universitare nga Biblioteka Kombëtare; kanë filluar të ndërtohen hallkat e bashkëpunimit e të komunikimit intensive me Fakultetet e Universitetit të Prishtinës për të parë nevojat e studentëve dhe, në këtë mënyrë, sipas këtyre kërkesave, të bëhet pasurimi i këtij koleksioni.

Njëra nga sallat e bibliotekës do të pajiset me libra dhe me kompjuterë që do të shërbejnë për të bërë kërkime për materiale në internet dhe gjatë tërë kohës në atë sallë do të jetë i pranishëm një bibliotekar referal për t'u dalë në ndihmë studentëve.

Është duke u punuar që të sigurohet edhe një objekt tjetër, i cili do të shërbejë si Qendër e Bibliotekës Universitare - qendër koordinuese e të gjitha koleksioneve të Universitetit të Prishtinës dhe atëherë studentët do të mund të kenë më shumë hapësirë dhe shërbime më të mira.



# Përkrähja e bibliotekarisë amerikane për Kosovën

BUKURIJE HALITI,  
ARDIAN HAXHAJ

**S**pecializimi në Amerikë, në fushën e bibliotekarisë moderne, i nëntën kandidatëve nga Kosova dhe bartja e përvojës amerikane këtu, paraqet një përgjegjësi dhe sfidë për të marrë pjesë në një projekt për formimin, zhvillimin dhe modernizimin e shërbimeve bibliotekare, në kuadër të Qendrës së Bibliotekës Universitare.

Marrje a njohurive teorike, përballja me përvojat që zhvillohen në fushën e bibliotekarisë dhe të informacionit, kanë qartësuar një vizion të ri të veprimit se si duhet punuar dhe çfarë duhet bërë në konsolidimin e projekteve dhe strategjive të mëtejshme për realizimin e një sistemi informatik bibliotekar te ne.

Gjatë kësaj kohe të qëndrimit atje, bibliotekarinë e pamë dhe e kuptuam në shumë dimensione, që nga lëndët në fushën e studimeve postdiplomike e deri te metodat praktike të punës nëpër bibliotekat universitare të njohura në shtetin e Masaçusetsit, si dhe trajnimet që kishin të bënin me disiplinat e shkencave të informacionit.

Në Kolegjin Simmons, lëndët postdiplomike kanë përfshirë udhëzimet e specializuara në zhvillimin dhe menaxhimin e bibliotekave, shërbimet informative elektronike, referencat virtuale, përfitimet dhe sfidat e teknikave informative digjitale; këto udhëzime janë parë edhe në mënyrë praktike nëpër shumë biblioteka. Puna praktike dhe vizitat kanë dhënë një vizion se si duhet të duken bibliotekat në të ardhmen në vendin tonë.

Përveç vizitave në biblioteka të ndryshme, vizitë me rëndësi ishte ajo në Bibliotekën e Kongresit, biblioteka më e madhe në botë. Aty, për tri ditë me radhë u njofuam me punën, metodat dhe veprimtarinë e gjithanshme të kësaj biblioteke. Për së afërmi ne i pamë disa prej departamenteve që i ka kjo bibliotekë, si atë të zhvillimit të koleksioneve, ruajtjes së informacioneve, projektin Kujtesa amerikane (American memory), të katalogimit etj., që ishin një përvojë e mirë se



si departamentet e përfshira në kuadër të një biblioteke duhet të jenë funksionale dhe njëherit edhe të dobishme.

Në Kosovë, bibliotekat deri vonë, janë parë dhe trajtuar vetëm si institucione kulturore pasive. Të ne për një kohë është menduar vetëm me koncepte iluministe për bibliotekën, dhe nuk është menduar si një institucion që duhet të kryejë punë praktike, produktet e të cilës duhet t'u distribuohen të gjithë përdoruesve. Trajnimi në Amerikë na ka dhënë mundësi për të kuptuar mirë konceptin ndaj bibliotekave dhe bibliotekarisë në përgjithësi; janë bërë vizita dhe është parë nga afër se si punohet në dhjetëra biblioteka të rëndësishme amerikane, duke filluar nga bibliotekat universitare e publike e deri te bibliotekat e specializuara vetëm për fusha të caktuara.

Sfidat që e presin bibliotekarinë tonë në përgjithësi, qëndron në ristrukturimin dhe ndryshimin kualitativ të imazhit të saj. Biblioteka bashkëkohore dhe bibliotekaria në përgjithësi sot është në shërbim të studentëve, hulumtuesve dhe të gjithë të interesuarve që u duhen materiale e të cilat mund të jenë në biblioteka. Sot bibliotekat janë duke bërë përpjekje konkurruese se cila po kryen shërbime më të shpejta, më të shumanshme dhe më efikase. Për shembull, në qoftë se një libër i kërkuar në një fushë të caktuar dihet se


është botuar dikund, qoftë brenda apo jashtë vendit, e që cilësohet se ka peshë në një disiplinë të caktuar, atëherë bibliotekat bëjnë përpjekje që t'i sigurojnë një numër të kopjeve, me këtë lexuesit interesohen se cila bibliotekë e ka në fondin e vet e kështu me radhë. Por, sfida më e madhe sot në bibliotekarinë e vendeve të zhvilluara është posedimi, organizimi dhe distribuimi sa më i madh i librave elektronike, artikujve elektronikë dhe gjithçka tjetër që hynë si material bibliotekar nëpër faqet e internetit. Një hapësirë të madhe në bibliotekarinë amerikane sot është duke zënë edhe bibliotekaria online, ku të interesuarit mund t'i kryejnë shërbimet e tyre dhe sugjerimet përmes vijës elektronike; email, chat, skype etj. Me një fjalë digjitalizimi i bibliotekarisë ka çuar edhe drejt digjitalizimit të shërbimeve bibliotekare. Së fundi mund të thuhet se, sot, bibliotekaria bashkëkohore po shkon drejt disiplinave të teknologjisë informative. Bibliotekaria amerikane njëherë për njëherë është shembulli më i mirë në botë se si duhet të transformohet në mënyrë cilësore roli dhe ndikimi i bibliotekarisë nga ai iluministo-arsimor dhe pasiv në një shkencë moderne informative, si shkencë për ruajtjen, selektimin dhe distribuimin e materialit, qoftë ai në letër, qoftë digjital.



# Mbështetja dhe zhvillimi i ligjit për kopjën e detyrueshme

Njëra nga format për pasurimin e fondeve të Bibliotekës Kombëtare, që ka paraparë Kuvendi i Kosovës, me Ligjin për Bibliotekat, është edhe kopja e detyrueshme. Shprehimisht në nenin 39 të këtij ligji thuhet: „Çdo person ose subjekt që boton publikacione në Kosovë, që i dedikohen shfrytëzimit publik, detyrohet që pesë kopje të çdo botimi t'ia dërgojë Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, në afat prej 30 ditësh nga dita e botimit, e nëse botuesi nuk është identifikuar ose është identifikuar rrejshëm (i panjohur), përkatësisht nuk ka vendqëndrim ose seli në Kosovë, këtë detyrim do ta kryej shtypshkronja, përkatësisht subjekti që ka bërë riprodhimin". Ndërkaq që neni 22.1.3, Bibliotekën Kombëtare të Kosovës e përcakton: "... qendër të marjes dhe depozitimit të kopjes së detyrueshme". Prandaj, duke u nisur nga ky përcaktim ligjor, e me qëllim të pasurimit të fondeve bibliotekare, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, u është drejtuar të gjithë botuesve me një kërkesë duke iu bërë të ditur për obligimin e tyre si botues, njëherësh me një njoftim të veçantë ka publikuar edhe në shtypin ditor me qëllim të sensibilizimit të botuesve lidhur me rëndësinë e kopjes së detyrueshme. Ndërkohë Shërbimi i Pasurimit, i cili funksionon në kuadër të Departamentit të Përpunimit të Koleksioneve Bibliotekare të BKUK-së ka organizuar takime të veçanta me botuesit kryesorë, takime të cilat kanë qenë të suksesshme, ngase si rrjedhojë e këtyre takimeve është krijuar një shkallë e vetëdijesimit që ka rezultuar me kryerjen e obligimit të dorëzimit të kopjes së detyrueshme. Sa për ilustrim duhet përmendur që vetëm gjatë vitit 2005 janë pasuruar fondet e librave të Bibliotekës me 550 tituj me 2750 ekzemplarë nga kopja e detyrueshme. Ka pasur vërejtje dhe interpretime nga botuesit se kopja e detyrueshme në pesë ekzemplarë është ngarkesë për buxhetin financiar të botuesit, sidomos kur merret parasysh botimi i kompleteve të veprave apo librave të rëndësishëm me vlera të veçanta që në treg kushtojnë shtrenjtë.

Porse, shpresohet që në të ardhmen, botuesit e mëdhenj në Kosovë, të cilët botojnë tituj të shumtë brenda vitit të kenë përkrahje financiare institucionale ose të përfitojnë lehtësi në tatim dhe qarkullim të librit; dhe e



gjithë mbrojtje të bëhet nëpërmjet ligjit.

Është përparësi e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare se arrin të menaxhojë me informacioni se çfarë botohet dhe nga cili botues brenda viti, meqë Biblioteka pajisë botimet e tyre me CIP (Katalogimin në publikim) dhe me numër të ISBN-së (Numri Standard Ndërkombëtar i Librit). Kjo i mundëson bibliotekë të përcjellë veprimtarinë botuese në Kosovë dhe të pasurojë fondet me këto botime nëpërmjet kopjes së detyrueshme, por edhe blerjes. Në këtë kontekst, është e rëndësishme që të vihen nën kontroll dhe të sanksionohen me ligj, në mënyrë që të mos u lejohet botuesve të papërgjegjshëm dhe shtypshkronjave që të shtypin dhe botojnë në mënyrë ilegale, duke mos i pajisur botime e veta me CIP dhe ISBN. Kjo e dëmton veprimtarinë botuese por dhe e bën tregun e botimeve të paqëndrueshëm dhe në një konkurrencë pa parime.

Duke qenë se shoqëria Kosovare gjendet në fazën e tranzicionit, ende më shumë duhet të punohet në vetëdijesimin për zbatimin e ligjeve, por dhe avancimin e tyre. Shpresojmë që në të ardhme e afërt, botuesit, shtypshkronjat dhe të gjithë ata që në një formë a tjetër merren me librin, të përmbushin obligimet e tyre ligjore por dhe kombëtare, ngase në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës ruhet i tërë thesari i kulturës që krijohet në Kosovë.

*Izet ABDYLI*

# BKUK pasurohet me tituj të rrallë dhe të veçantë

**T**radita e mëhershme - 50-vjeçare, e zhvillimit të koleksioneve në BKUK është përcjellë me shtërngesa, kufizime, kontroll e censurë politike e ideologjike. Duke i çiruar koleksionet nga ky ngatërrim, BKUK ka përcaktuar planin për zhvillimin dhe pasurimin e koleksioneve bibliotekare të BKUK-së, e si rrjedhojë edhe të fondit të albanologjisë, pjesë e të cilit është ky koleksion librash në gjuhë të huaja, që përbëjnë vlera historiko-dokumentare të rralla dhe të veçanta, të shkruara për shqiptarët dhe për origjinën e tyre.

Autorët e këtyre librave janë: antropologë, udhëpërshkrues, konsuj, misionarë, diplomatë, historianë, politikanë etj.

Librat përfshijnë dëshmi e ngjarje spikatëse, me peshë të rëndësishme - përfaqje në materiale e dokumente historike, të dhëna, dokumente, kërkime, biografi e autobiografi, ligjërata, studime, përshkrime për shumë ngjarje e dukuri, që paraqesin jetën e zakonit e shqiptarëve, besimin e tyre, zhvillimet historike e politike, pikëpamjet për ta.

Këta tituj të rrallë dhe të veçantë, që përbëjnë 23 njësi, janë blerë në fund të vitit 2005.

Ky koleksion i librave ka një shtirje tematike e kronologjike të gjerë, duke përfshirë tituj që janë botuar mes viteve 1822 - 2004.

Në katalog, njësitë janë të radhitura në mënyrë kronologjike me përshkrim bibliografik dhe një përmbledhje të shkurtër të përmbajtjes.

1. Ken Booth (Editor), The Kosovo Tragedy: the Human Rights Dimensions, London-New York, 2000  
*Ky vëllim është një përpjekje për të shqyrtuar tragjedinë nga perspektiva e të drejtave njerëzore në të gjitha dimensionet. Një grup ndërkombëtar i specialistëve debatojnë çështjet kyçe: përvojat nga Bosnja; konceptet e pazgjithëhura; të këqijat e bëra ndaj viktimave; çështjen e luftimit; situatën në Kosovë në vitin 2000 etj.*
2. Gwen Robyns, Geraldine of the Albanians: the Authorized Biography, London, 1987  
*Biografi e Autorizuar e Mbretëreshës Gjeraldinë. Libri përmban po ashtu edhe disa fotografi të familjes mbretërore shqiptare.*

3. Julian Brazier, Jamie Cann, Lessons of Kosovo. Volume I - II: Report and Proceedings of the Committee, London, 2000

*Volume I, Report and Proceedings of the Committee Volume II, Minutes of Evidence and Appendices Ligjërata që janë mbajtur në Dhomën e Përfaqësuesve të Qeverisë Britanike (House of Commons) rreth Kosovës.*

4. Leslie Gardiner, South to Calabria, Edinburgh & London, 1968

*Udhëpërshkrim me detaje shumë interesante për Kalabrinë, në të cilin përfshihen edhe disa fotografi që ilustronin detaje të rëndësishme për vendin dhe kohën kur autori realizoi udhëtimin.*

5. Stavro Skendi (Editor), Albania: East-Central Europe under the Communists, London, 1957

*Ky studim reflekton gjendjen e njohurisë amerikane dhe njohurive perëndimore në përgjithësi mbi zhvillimet brenda Shqipërisë komuniste. Autorët dhe botuesit e këtij studimi janë përpjekur të sigurojnë se ai është përshkrim i saktë dhe objektiv dhe analizë e asaj çka ka ndodhur në Shqipëri nën sundimin komunist.*

6. Edith Durham, High Albania: A Victorian Traveller's Balkan Odisey, London, 2000

*Ky është një eksplorim magjepsës i dorës së parë i një prej vendeve më së paku të udhëtuara në rajonin e Ballkanit. Ironike të thuhet - udhëtarët kanë pasur më shumë qasje në vend në vitin 1909 se sa pjesën më të madhe të kohës gjatë shekullit 20.*

7. T. J. Winnifrieth, Badlands - Borderlands: A history of Northern Epirus/ Southern Albania, London, 2002

*(Studim krahasues që përmban edhe disa ilustrime si dhe 8 harta)*

*Përshkrim i jetës dhe kulturës në Shqipërinë Jugore, në anën e kundërt të Korfuzit, vende këto gjithmonë të vështira për t'u vizituar dhe posaçërisht në periudhën komuniste nga 1944 deri më 1992. Ky rajon përmban shumë monumente të rëndësishme, siç janë*

*ato të Apolonisë dhe të Butrintit.*

8. John Phillips, Macedonia: Warlords and Rebels in the Balkans, London-New York, 2004

*Copëtimi i Jugosllavisë në vitin 1990 shkatërroi Ballkanin, duke lënë të lirë tmerrin e nacionalizmit ekstrem. Maqedonia duket të ketë genë e kursyer nga gjakderdhja. Në fakt ajo vetëm ishte shtyrë për më vonë. Republika e ish-Jugosllavisë - Maqedonia e pavarësuar, rishtazi mbetet fuqi baruti që pritet të eksplozojë.*

9. The life of Ali Pacha, of Janina, vizier of Epirus, surnamed Aslan, or the Lion: From various authentic documents, London, 1822



*Biografi politike; Autori e ka bazuar këtë punim në 'Vie d'Ali Pacha' nga M. Beauchamp, dhe shtjellon herë pas here me një hyrje të fragmenteve interesante nga puna e disa prej atyre që kanë vizituar Tyrantin e vonshëm të Epirit'.*

10. Wadham Peacock, Albania: The Foundling State of Europe, London, 1914

*Studim antropologjik - i përcjellë me disa fotografi të vjetra nga pjesë të ndryshme të Shqipërisë. Peacock ishte konsull i*

përgjithshëm në Shqipërinë e Veriut.

11. Nigel Heseltine, Scarred Background: a Journey Through Albania, London, 1938

*Udhëpërshkrim që del nga një udhëtim nëpër vise të ndryshme të Shqipërisë. Njërin nga kapitujt e librit autori e ka titulluar "Pader Fichta and the National Literature" (At Fishta dhe letërsia kombëtare). Libri përmban edhe disa fotografi që e ilustronin mjaft mirë këtë udhëpërshkrim.*

12. Elyesa Bazna, I was Cicero, London, 1962

*Ky është një tregim i mrekullueshëm spiuni-mi. Tregimi rrëfëhet nga vetë spiuni. Tregim i vërtetë dhe i paharrueshëm i shërbëtorit (gardërobistit) me origjinë shqiptare, i cili u bë spiuni kryesor për gjermanët gjatë Luftës së dytë Botërore.*

13. Frederick Moore, the Balkan Trail, London, 1906

*Udhëtim dhe eksplorim në Ballkan; përmban të dhëna mbi Shqiptarët e Mitrovicës dhe po ashtu edhe referenca të tjera.*

14. Stavro Skendi, Albanian And South Slavic Oral Epic Poetry: Memoirs of the American Folklor Society, volume 44, Philadelphia, 1954

*Shumë pak është shkruar për poezinë gojore epike dhe edhe më pak për marrëdhënien e saj me këngët heroike të Sllavëve të Jugut. Studimi i tanishëm merret me të dyja. I prezantuar në vitin 1951 si disertacion doktorature në departamentin e gjuhëve sllave në Universitetin Columbia, është ripunuar në vazhdimësi.*

15. Gary Loyd Bevington, Albanian phonology (Albanische Forschungen), München, 1974

*Pjesa më e madhe e kësaj vepre i është dedikuar një trajtimi sistematik të problemeve fonologjike dhe morfologjike të shkaktuara nga zgjedhimi i foljeve dhe lakimi i emrave në shqip.*

16. Noam Chomsky, The New Military Humanism : Lessons From Kosovo, London, 1999

*Pothuajse rrëmuja ishte qetësuar nga bombardimi i NATO-s në vitin 1999 në Serbi kur komentuesi politik i profilizuar Naom Chomsky nxori veprën "Humanizmi i Ri Ushtarak" (The New Military Humanism), e cila ngrit pyetje të rënda, shqetësuese rreth motiveve të Shteteve të Bashkuara dhe Anglisë - dy ithtarëve më të zëshëm nga Forcat Aleate*

*Vepruese dhe për efikasitetin në punën e tyre.*

17. Marcellus Donald Alexander von Redlich, The unconquered Albania, [USA], 1935



*Përmbledhje e historisë së Shqipërisë.*

*Brenda këtyre faqeve historia e Mbretërisë së Shqipërisë është mbledhur me qëllim që t'i jepet lexuesit një shikim i shpejtë por domethënës i pa minimizuar në ndonjë nga pikat kryesore në kronologjinë e ngjarjeve, e një kombi unik, i cili është i një interesi të madh e i rëndësishëm në botë, por për detajet më intime të krijimit të tij pak kush di.*

18. Albrecht Schnabel (Editor), Kosovo and the Challenge of Humanitarian Intervention : Selective Indignation, Collective Action, and International Citizenship, Tokyo- New York- Paris, 2000

*Ky publikim ofron interpretime të krizave të Kosovës nga disa perspektiva: grupeve në konflikt, aleatëve të NATO-s dhe, po ashtu, edhe regjionit që e ka rrethuar konflikti. Perspektivat e vendit pasohen nga analiza studimore të normativave afatgjate, të pasojave funksionuese dhe strukturore të krizave të Kosovës për politikën botërore.*

19. Peter Van Ham and Sergey Medvedev (Editors), Mapping European Security after Kosovo, New York and Manchester, 2002

*Ky studim ofron horizonte të reja në atë se si Kosova ka marrë formë në Evropën e re - duke thyer hipotezat tradicionale në fushën e studimeve të sigurisë duke lënë anash pikëpamjet teorike botërore që theksojnë mendimin strategjik mbizotërues për ngjarjet në Kosovë. Studimi adopton një qasje të re*

*kritike, edhe duke rishqyrtuar e dekonstruktuar hipotezat ortodokse rreth natyrës së sigurisë Evropiane dhe asaj globale.*

20. Dick Leurdijk, Dick Zandee, Kosovo: From Crisis to Crisis, Burlinglon (England), 2001

*Ky tekst i adresohet konfliktit në Kosovë. Autorët analizojnë konfliktin duke përdorur një numër të ndryshëm temash: ndikimin në ngjarjet e tanishme, përpjekjet për të zgjedhur një zgjidhje, nevojën për ndërhyrje ushtarake dhe të tjera. Qëllimi i librit është të ofrojë një kuptim më të thellë të këtij konflikti.*

21. Stephen Schwartz, Kosovo:

Background to a War (Anthem Slavic and Russian Studies), London, 2000

*KOSOVA: Histori e një lufte (UK) nga Stephen Schwartz ofron një përmbledhje të shkurtë por të detajizuar të rrymave kryesore historike dhe atyre politiko kulturore që krijuan nevojën për intervenimin e NATO-s. Ky studim prezanton një analizë politike të çështjeve qendrore ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve.*

22. Mary Buckley and Sally N. Cummings (Editors), Kosovo: Perceptions of War and Its Aftermath, London - New York, 2001

*Ky libër bën hapin e parë të theksojë rolin e perceptimit në politikën ndërkombëtare. Qasjet konceptuale, modelet ose kornizat përmes të cilave aktorët politikë e shohin realitetin në radhë, ndikojnë në mënyrën se si ata i kuptojnë sjelljet e të tjerëve dhe reagimet e tyre.*

23. Peter R. Prifti, Confrontation in Kosovo: The Albanian-Serb Struggle, 1969-1999, New York, 1999

*Ky koleksion i rëndësishëm dhe i bërë në kohën e duhur; i punimeve hulumtuese mbi konfliktet shqiptaro-serbe në '30 vitet e fundit, fokusohet në faktorët kulturor, politik dhe socio-ekonomik që kanë qar në krizën e tashme në Kosovë. Shkruar nga një student udhëheqës i marrëdhënive ndërkombëtare Ballkanike, "Konfrontimi në Kosovë" (Confrontation in Kosovo) është një deklaratë autoritative e problemeve komplekse që ndikojnë në konfrontim.*

24. Kurt R. Spillmann , Joachim Krause (Editors), Kosovo: Lessons Learned for International Cooperative Security (Studies in Contemporary History & Security Policy), Volum 5, Bern, 2000

*Ky libër në mënyrë kritike ekzaminon përp-*

*jekjet e ndryshme për të zgjedhur problemin e Kosovës me mënyra të sigurisë së përbashkët. Ai gjithashtu merret me probleme që kanë filluar pas marrëveshjes së 9 Qershorit 1999. Po ashtu, ai përipiqet për të hedhur dritë në aspektet më të gjera regionale dhe ndërkombëtare të asaj krize.*

25. Lukas D. Tsitsipis, A linguistic Anthropology of Praxis and Language Shift: Arvanitika (Albanian) and Greek in Contact, Oxford, 1998

*Një ndryshim lingvistik në Ballkan është tema e këtij libri. Ai fokusohet në gjuhën Arvanite, një variant i shqipes i folur në Greqi, i cili është nën kërcënim përmes një procesi të fërkimit. Të gjitha aspektet e ndryshimit janë ekzaminuar, duke përfshirë makro-proceset, kushtet socio-politike dhe aspektet pragmatike.*

26. Susan E. Pritchett Post, Women in Modern Albania: Firsthand Accounts of Culture and Conditions from over 200 Interviews, North Carolina and London, 1998

*Pjesërisht histori gojore, pjesërisht memoare, libri përshkruan mikpritjen edhe natyrën shpirtërore që i përkasin femrave shqiptare. Autorja ka marrë tregime të tyre që janë frymëzuese dhe në disa raste edhe pikëlluese gjatë disa intervistave që ajo ka bërë nëpër qytete dhe fshatra.*

27. Torgny Sommelius, The Iron Gate of Illyria, London, 1955

*Kujtime udhëtimesh, shënime për mbresat nga Jugosllavia; përfshin edhe pjesë nga Kosova. E përkthyer nga suedishtja.*

28. John Simpson, Strange Places, Questionable People: Updated with a New Chapter on Kosovo, London, 1999

*John Simpson ka mbuluar një numër të jashtëzakonshëm të ngjarjeve botërore në vendet e lëna pas dore. Me këtë libër ai i sjell lexuesit një kuptim më të madh të asaj çka ishte duke ndodhur në atë kohë e po ashtu edhe të asaj se si është jeta si korrespondent i BBC-së.*

29. Ivo H. Daalder, Michael O'Hanlon, Winning Ugly: NATO's War to Save Kosovo, Washington, D.C., 2000

*"Winning Ugly" është libri i parë serioz për të vlerësuar luftën e parë të NATO-s, një fushatë 11 javore bombardimi e zhvilluar ndaj Serbisë për të shtyrë trupat e saj të dalin nga Kosova në pranverën e vitit 1999.*

30. Alex J. Bellamy, Kosovo and International Society, New York, 2002

*Ky libër shpjegon angazhimin ndërkombëtar me Forcat Aleate Vepruese në konfliktin e Kosovës në rastin e shpërbërjes së Jugosllavisë. Ai tregon atë se si Kosova më qëllim ishte përjashtuar nga kërkimi për paqe në Jugosllavi para se të hyhet në demonstrata dhe se si një konsensus ndërkombëtar i lëkundur ishte krijuar për të mbështetur sulmet ajrore në vitin 1999.*

31. Bernard Newman, Albanian backdoor, London, 1936

*Përshtypje impresioniste nga Shqipëria Veriore dhe Qendrore dhe nga rajonet shqiptare në Serbi.*

32. The Kosovo dossier: A collection of essays and articles, including papers presented at the International Conference "The end of the American Century" held in London in April 1999.

*The Kosovo dossier: Një koleksion i eseve dhe artikujve, duke përfshirë punime të prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare "The end of the American Century" e mbajtur në Londër në prill 1999.*

33. Ronald Mathews, Sons of the Eagle: Wandering in Albania, London, 1937

*Një udhëtim i autorit nëpër vise të ndryshme shqiptare, nxjerr këtë përshkrim interesant dhe mjaft të rëndësishëm për shqiptarët dhe vendbanimet e tyre.*

34. Nicholas William Bethell, The great betrayal: The untold story of Kim Philby's biggest coup, London, 1984

*Nën mbikëqyrjen e agjentëve britanikë dhe amerikanë, grupe të vogla mërgimtarësh shqiptarë u trajnuan për t'u infiltruar në Shqipëri ku ata do të shpërndanin propagandë, do të bënin akte të sabotimit, do të rekrutonin burra vendës dhe do të përgatitnin rrugën për një invazion më të rëndësishëm.*

35. Vladimir E. Orel, A Concise Historical Grammar of the Albanian Language: Reconstruction of Proto-Albanian = E. [Gramatikë historike koncize e gjuhës shqipe: rikonstruktiv i proto-shqiptarëve], Leiden-Boston-Köln, 2000


36. John Foster Fraser, Pictures from the Balkans = [Fotografi nga Ballkani], London, New York, Toronto and Melbourne, 1912

*Përshkrim i gjendjes së shteteve ballkanike në prag të rënies së Perandorisë Osmane*

37. David Smiley, Albanian Assignment, London, 1984

*Kjo biografi tërheqëse rrëfen me hollësi dy misione të agjentit të inteligjencës britanike me emrin Smile në vitet 1943 dhe 1944 për luftëtarët shqiptarë të rezistencës. Së pari me partizanët komunistë dhe atëherë me grupet nacionaliste dhe monarkiste, ai ndihmoi të organizojë dhe të armatosë shqiptarët kundër forcave okupuese italiane dhe gjermane. Politika e autoriteteve londineze dhe grindjet vrasëse ndërmjet fraksioneve shqiptare tejkalohen, por aventura të ndryshme me guerilë, nganjëherë tragjike, absurde dhe prekëse dalin në jetë.*

38. Fred Abrahams, Human Rights Watch (Organization), Elizabeth Andersen, Human Rights Watch Staff, Humanitarian Law Violations in Kosovo, New York, Washington, London, Brussels, 1998



*Ky raport është i bazuar në një hulumtim të bërë në Kosovë, Mal të Zi dhe në Shqipëri ndërmjet majit dhe shtatorit 1998.*

39. William Ash, Pickaxe and rifle: the Story of the Albanian People, London, 1974

*"Pickaxe and rifle" është një studim politik dhe sociologjik i Shqipërisë si shtet socialist në Evropë. Asnjë histori adekuate nuk është publikuar në periudm derisa William Ash e shkroi këtë libër.*

40. Independent International Commission on Kosovo, The Kosovo Report, Conflict \* International Response \* Lessons Learned, Oxford

University Press, 2000.

*Ky libër dokumenton dhunën kundër të gjitha viktimave pa marrë parasysh grupet e tyre etnike dhe po ashtu edhe punën për paqe dhe për pajtim ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në Kosovë dhe Serbi.*

41. John Wilkes, *The Illyrians*, Oxford UK & Cambridge USA, 1992

*John Wilkes përshkruan gjeografinë e tokave Ilire dhe hulumton rajonin në parahistori, periudhat greke, romake dhe atë mesjetare. Ai diskuton për artin e Ilirëve, kulturën e informimit, religjionin, traditat dhe po ashtu edhe gjuhën e Ilirëve dhe lidhjen e saj me gjuhët Indo-Evropiane.*

42. Joseph Buckley (Edit), *Kosovo Contending Voices on Balkan Interventions*, Michigan, USA, 2000

*Ky vëllim prezanton shumë zëra në konfliktin e Kosovës me vizione të debatueshme dhe me deklarata. Një koleksion jashtëzakonisht i llojlojshëm i eseve, memoareve, letrave dhe intervistave që përbëhet nga një spektër i fuqishëm i pikëpamjeve mbi konfliktin në Kosovë dhe fushatën ajrore të NATO-s.*

43. Constantine Anastasi Chekrez, *ALBANIA: Past and Present*, New York, 1919

*Një përmbledhje e historisë së Shqipërisë dhe e shqiptarëve, nga antika - periudhat kyçe të historisë së tyre - deri në Luftën e Parë Botërore, duke përfshirë të dhëna interesante të jetës religjionit, ekonomisë, të karakteristikave nacionale, të migrimeve të shqiptarëve gjatë historisë dhe për perspektivat e këtij vendi.*

44. Jason Tomes, *King Zog: Self-made monarch of Albania*, New



Baskerville, 2003.

*Libri më i kompletuar deri më tash për Mbretin Zog.*

*Një analizë jashtëzakonisht e ndritur e politikës dhe diplomacisë së asaj periudhe. I gjallë dhe plot atmosferë, por i bazuar në një hulumtim solid dhe i përpiktë, ky është një imazh i jashtëzakonshëm i njërit nga figurat më intriguese në historinë e Ballkanit të shekullit XX.*

45. Philip E. Auerswald and David P. Auerswald (Editors) *The Kosovo Conflict: A Diplomatic History Through*, Cambridge / The Hague, 2000

*Grumbullim i koleksionit përfundimtar të dokumenteve zyrtare të pa klasifikuara që e rrethojnë këtë ngjarje. E pasur me detaje, Libri "The Kosovo Conflict" i vendos ngjarjet në kontekst. Secili kapitull ka si parathënie një ese dhe një kronologji që përmbledh ngjarjet e atij kapitulli. Pjesa kryesore e kapitullit përmban marrëveshje kyçe, fjalime, komunikata dhe deklarata të organizatave kryesore vendëse dhe ndërkombëtare të përfshira në Ballkan.*

46. Stuart E. Man, *An Historical Albanian-English Dictionary* [Fjalor historik shqip-anglisht], London, New York, Toronto, 1948

47. Peter Gray (Editor), Sebastian Cox (Editor), *Air Power History: Turning Points from Kitty Hawk to Kosovo* (Cass Series--Studies in Air Power, 13), London, 2002

*Ky vëllim ekzaminon teorinë dhe praktikën e fuqisë ajrore nga zanafilla e tij e hershme. Kontribuesit janë tërhequr nga akademja dhe nga ushtria dhe ata përfaqësojnë disa nga ithtarët kryesorë botërorë të kësaj çështje. Të gjitha kohërat e rëndësishme të përdorimit të fuqisë ajrore janë ekzaminuar: disa janë qartazi pika kthesë, derisa të tjerat prezantojnë zhvillim në vazhdimësi.*

*Një kapitull i këtij libri ofron një përmbledhje të hulumtimit të Air Historical Branch mbi aspektet strategjike të konfliktit të Kosovës të vitit 1999.*

48. Miranda Vickers, James Pettifer, *Albania: From Anarchy to a Balkan Identity*, London, 1997

*Autorët na ofrojnë një analizë të asaj se si morali, religjioni, ekonomia, politika dhe identiteti kulturor i popullit shqiptar është*

*duke u ridefinuar dhe nuk lënë asnjë dyshim se e ardhmja e Shqipërisë është pashmangshëm e lidhur me të ardhmen e Ballkanit si tërësi. Thënë shkurt, ata na tregojnë neve pse Shqipëria është e rëndësishme.*

49. Owen Pearson, *Albania and King Zog (Independence, Republic and Monarchy 1908-1939)*, London, 2004  
*"Albania in the Twentieth Century, A History" prezanton një arritje jo paralele në shkollimin në Shqipëri. Owen Pearson prezanton një imazh të plotë të shekullit 20 në Shqipëri, nga ndarja e saj nga Perandoria Otomane në vitin 1908 deri në luftën e Kosovës në vitin 1999. Në detaje magjepsëse, Pearson bën kronikë për monarkinë e Mbretit Zog dhe kohën e luftës ku Shqipëria bëhet vend betejë për ushtritë greke, italiane dhe gjermane.*

50. Howard Clark, *Civil Resistance in Kosovo*, London, 2000

*Bota u zgjua tepër vonë për konfliktin ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës kur zaret ishin hedhur për luftë në vitet 1998-1999. Deri atëherë, vetë përmbajtja dhe solidariteti social i shqiptarëve të Kosovës në përballje me ultra nacionalizmit serb krijoi mundësi për veprime parandaluese të cilat perëndimi i kishte nxitur. Më në fund, megjithatë, politika jo e dhunshme e shqiptarëve të Kosovës pati sukses vetëm në shtyrjen e luftës, jo në shmagjen e saj.*

51. George Croly, Mohammed Ali. The Albanian - born soldier who became the Pasha of Egypt = [Mohamed Aliu. Shqiptari - ushtarak i lindur i cili u bë Pasha i Egjiptit], in Blackwood's Edinburgh, Vol. XLIX, No. CCCIII, pp. 65 - 82, 1841

*Një artikull i nxjerrë nga revista Blackwood's Edinburgh në 18 faqe.*

52. Ismail Kemal Bey, *The Memoirs of Ismail Kemal Bey*, Edited by Story. Somerville (ed), Preface by William Morton Fullerton, London, 1920  
*Memoare të Ismail Qemalit*

53. Tom Bevan, *The Insurgent Trail: A story of the Balkans*, London, Edinburgh, Dublin, and New York [s. a.]  
*Tregime të shkurtra nga Ballkani.*

**Përgatiti:** Lavdije Rrahmani

## AGJENCIA NDËRKOMBËTARE E ISBN-së NDËRRON SELINË

Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së, e cila për më tepër se 30 vjet me radhë u ofron shërbime dhe informacione më se 160 agjencive të botës, nga muaji prill do të ndërrojë "shtëpinë e saj" nga Biblioteka Shtetërore të Berlinit, do të bartet në Londër. Dr Hartmut Ualravens, drejtor aktual i Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së, gjithashtu do t'i dorëzojë postin Z. Brian Green, duke konsideruar se me emërimin e Z. Brian në krye të Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së, si drejtori i ri ekzekutiv, e sheh një të ardhme të mirë të koordinimit të sistemit të ISBN nga mbarë bota. Sipas tij, Brian Green ka punuar shumë ngushtë me ISBN për shumë vjet dhe i besohet të marrë përgjegjësitë e administrimit të ISBN-së.

Brian Green, vlerëson se marrja e kompetencave të përgjithshme të ISBN-së do të jetë një periudhë mjaft e rëndësishme menaxhuese, sidomos në faktin kur tash do të fillojë aplikimi i ri i sistemit të numrave të ISBN-së.

## BOTIME TË REJA PËR DEPOZITURËN E BIBLIOTEKËS SË NATO-s

Zyra Botuese e NATO-s, nga Brukseli, sipas marrëveshjes së mëhershme, vazhdon të pasurojë depoziturën e saj në BKUK me tituj të ri. Në Depoziturën e Bibliotekës së NATO-s në BKUK, si pjesë e rrjetit më të gjerë të bibliotekës, ditë më parë kanë arritur tituj të ri të botuar gjatë vitit 2005, të cilat karakterizohen me tema nga aktivitetet dhe objektivat e Aleancës si një organizatë transparente dhe jopolitike. Ndër titujt që vlen përmendur, të cilat njëkohësisht janë në dispozicion për lexuesit janë: "Menaxhimi i krizave", "Përgjigje ndaj terrorizimit", "Tërmetet - të ndërlidhura me fatkeqësi", etj. Në këtë kontingjent dhuratash kanë arritur edhe materiale të tjera audio-vizuale.



## ZËVENDËSSHEFI I ZYRËS RUMUNE VIZITON BKUK-në



Në bazë të marrëveshjes së nënshkruar më parë ndërmjet BKUK-së dhe Bibliotekës Kombëtare të Rumanisë, Zëvendësshefi i Zyrës Rumune në Prishtinë z. Gheorghe Bucura, i bëri një vizitë zyrtare në BKUK ku u bisedua për bashkëpunimin kulturor midis institucioneve të Kosovës dhe Institucioneve të Rumanisë. Z. Bucura, drejtorit të BKUK-së, Dr. Sali Bashotës, i ofroi bashkëpunim në shumë sfera me interes reciprok ndërmjet institucioneve kulturore të Rumanisë dhe të atyre të Kosovës. Bashkëpunimi do të përqendrohet kryesisht në fushën e letërsisë, përkthimi të letërsisë shqipe dhe rumune dhe anasjelltas, pastaj në fushën e bibliotekarisë me shkëmbimin e ekspertëve, në fushën e etnografisë përmes ekspozitave të ndryshme etj.



## FONDACIONIT SABRE DHE BIBLIOTEKA E KONGRESIT, NË PROJEKTIN PËR TË PËRKRAHUR BKUK-NË

Më 15 nëntor 2005, në Uashington DC, Fondacioni SABRE shënoi 35-Vjetorin e theme-limit të saj, me moton e quajtur "Ndihma Humanitare për Mendje".

Krahas përfaqësuesve të shumtë nga vende të ndryshme të botës, kësaj radhe në këtë përvojtor, edhe BKUK, përkatësisht Kosova mori pjesë. Gjatë kësaj ceremonie, u përfitua rasti për diskutime të dobishme me udhëheqësit e Fondacionit SABRE, gjë që rezultoi me një iniciativë të përbashkët ndërmjet Fondacionit SABRE dhe Bibliotekës së Kongresit, për një angazhim dypalësh të një projekt për të përkrahur BKUK-në për ndihmë me literaturë aktuale.

## PCG NDIHMON BIBLIOTEKAT E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS



THE ROYAL  
SOCIETY

Publishing

Arend Kuester, drejtor i PCG-së (Publishers Communication Group) është duke punuar në projektin përkrahës për Universitetin e Prishtinës, përkatësisht për bibliotekat e Universitetit të Prishtinës. Në një takim zyrtar, me përfaqësues të BKUK-së, në Boston, Kuester njoftoi për projektin e nisur për Kosovën dhe zhvillimin e korrespondenca me botues të shumtë nga tërë bota për qasje të lirë në publikimet e tyre shkencore. Ky projekt do të zgjasë dy vjet - nga dita e nënshkrimit të licencës. Gjithashtu, në kuadër të këtij projekti është realizuar qasja e lirë në shtatë tituj nga Royal Society, e cila do të zgjasë deri në fund të vitit 2009. Këto janë revista multidisiplinare dhe janë të vlefshme për fusha të ndryshme në Universitetin e Prishtinës. [http:// www. pubs.royalsoc.ac.uk](http://www.pubs.royalsoc.ac.uk).

## THE CLEVELAND CLINIC DISEASE MANAGEMENT PROJECT

### PROJEKTI "CLEVELAND CLINIC DISEASE MANAGEMENT" PËR SHKENCËN MJEKËSORE TË KOSOVËS

eIFL-net Rrjeti për Informacione Elektronike për Biblioteka, për Konsorciumin e Bibliotekave Elektronike në Kosovë, nga shkurti i këtij viti, i ka ofruar qasje falas në materiale elektronike, përkatësisht tekste shkencore me përmbajtje mjekësore. Këtë e ka realizuar përmes projektit "Cleveland Clinic Disease Management Project"

Botuesit potencialë të këtij projekti ofrojnë udhëzime dhe materiale për trajtimin e më se 150 sëmundjeve të ndryshme në këto fusha: Alergjia dhe Imunologji, Kardiologji, Dermatologji, Endokrinologji, Gastrologji, Hematologji, Hematologji/Onkologji, Sëmundje Infektive, Nefrologji, Neurologji, Psikologji dhe Psikiatri, Sëmundje të Mushkërive, si dhe për shëndetin femëror.

## KATALOGIMI ELEKTRONIK: AACR2 DHE METADATAT PËR BOTIMET SERIKE DHE MONOGRAFIKE, BKUK, PRISHTINË 2005.

Libri Katalogimi Elektronik: AACR2 dhe Metadatat për Botimet Serike dhe Monografike, shtjellon aspekte të zhvillimit të bazës së të dhënave dhe të katalogimit, me rëndësi të veçantë për bibliotekarinë. Përkthimi i këtij libri vjen si një udhërrëfyes në momentet më të nevojshme për bibliotekarinë në Kosovë, kur tashmë ka filluar procesi elektronik i katalogimit nëpërmjet programit Apleh 500, si dhe i përdorimit të rregullave të reja të katalogimit, sipas AACR2-it.

Libri është një përmbledhje shkrimesh të një mori autorësh eminent në fushë të katalogimit, të cilët trajtojnë pikëpamje të reja të standardeve të përpunimit. Në saje të rëndësishme, këto punime njëkohësisht janë botuar edhe në revistën profesionale amerikane "Cataloging & Classification Quarterly, nr.3-4, 2003".

Këto tekste mbulojnë një fushë të gjerë veprimesh, si dhe paraqesin rezultatet më të reja në fushë të katalogimit elektronik në botë për botimet serike dhe monografike; trajtohen probleme specifike nga AACR2-ja, ISBD-ja, MARC-u dhe ISSN-ja, e deri te Dublin Core. Po ashtu, në të trajtohen problemeve të ndryshme - përshkrimi i veprave të artit, numri identifikues i objektit dhe VRA Core Categories, pastaj nga skemat koduese, deri te skemat e metadatave, strategjia e metadatave e deri te çështjet e zbatimit të tyre në praktikë.

Vlera e këtyre shkrimeve është në nivelin në të cilin diskutohen këto probleme; llojllojshmërinë e temave që trajtohen në kontekstin e zhvillimeve dhe ndryshimeve të standardeve në fushë të bibliotekarisë, përkatësisht të AACR2; mënyrën se si bibliotekat ia kanë dalë të ecin karshi përparimeve bashkëkohore të teknologjisë së informacionit.



## BIBLIOGRAFI E LETËRSISË ARTISTIKE E PËRKTHYER NË SHQIP GJATË VITEVE 1944 - 2000, TOENA, TIRANË 2004

Bibliografja e njohur - znj. Vjollca Hysenbegas, pas punës disavjeçare, arriti të kurorëzojë me sukses punën e saj me botimin e veprës bibliografike "Bibliografi e letërsisë artistike e përkthyer në shqip 1944 - 2000", e cila nga përmasat dhe kriteret e hartimit, është, në të vërtetë, një histori e letërsisë botërore të përkthyer në shqip.

Përkthimi i letërsisë së huaj përthithi në këtë periudhë kohore frymëzimin dhe energjinë e qindra njerëzve të talentuar e të mësuar, të cilët, duke mos pasur mundësi e duke mos u lejuar të thonë lirisht mendimin e tyre individual në fusha të dijes të kulturës, ata iu drejtuan kulturës shqiptare, punuan për të, nëpërmjet përcimit në shqip të kulturës dhe të mendimit filozofik e artistik botëror. Kjo veprimtari e fuqishme me vlera të shquara, u pasqyrua dhe doli në dritë, nëpërmjet kësaj bibliografie të hartuar nga znj. Hysenbegas.

Kjo bibliografi u bën homazh të gjithë atyre përkthyesve që s'janë më mes nesh dhe i motivon për përkthim cilësor të gjithë ata që vijnë të kontribuojnë në fushën e përkthimeve.

Kjo bibliografi, që përfshin 2300 njësi bibliografike, me 558 faqe, është e rënditur sipas mbiemrit të autorëve, kurse për librat me shumë autorë ose pa autor, është e radhitur sipas titujve të librave.

Libri përmban edhe një indeks shumë të pasur, që përfshin treguesit alfabetik sipas titujve, autorëve të përkthyer në shqip, përkthyesve, redaktorëve, piktorëve, ilustratorëve, përshtatësve, mbledhësve, autorëve të parathëniesve, të pasthëniesve e të shënimeve, si dhe në fund fare - i botuesve.

"Bibliografia e letërsisë artistike e përkthyer në shqip 1944 - 2000", e hartuar mbi kritere shkencore, e plotë, e përpiktë dhe pa asnjë kapërcim, është një bibliografi model nga më të saktat, me të mirat dhe më interesantet në kulturën tonë.

Kjo bibliografi, që është një dokument i hollësishëm, do të vlejë si një libër reference, si një manual i çmuar për këdo që dëshiron të dijë për përkthimin e letërsisë artistike në Shqipëri.

GJ. BERISHA

